

SHARRCEM

a  **TITAN** Group Company

PËRGJEGJËSIA SHOQËRORE
E KORPORATËS (CSR)
DHE QËNDRUESHMËRIA

2012
RAPORT

SHARRCEM SH.P.K.

Adem Jashari p.n.
71510 Hani i Elezit
Kosovë
Tel. 00 381 290 385 500
Fax. 00 381 290 385 510
www.sharrcem.com

Personi Kontaktues: Besa E. Ramadani
Tel. 00 381 290 385 511
E-mail: besa.ramadani@sharrcem.com

Sharrcem është nën pronësinë e plotë të SHARR BETEILIGUNGS GmbH
Nga Hamburgu, Gjermani, anëtar i Titan Cement Group

SHARRCEM SH.P.K.

**RAPORT
PËRGJEGJËSIA SHOQËRORE E KORPORATËS
(CSR) DHE QËNDRUESHMËRIA
2012**

Ky raport është raporti i parë vjetor i Sharrcem SH.P.K. Përkushtimi i kompanisë vazhdon më tej me prezantimin e raportit vjetor të CSR në të ardhmen; raportet e tilla do të jenë në përputhje me udhëzimet e raportimit të Titan Group si pjesë e veprimeve të GRI të grupit dhe qëndrueshmërisë. Prandaj të gjitha elementet e raportit parashtrihen përmes bazës së të dhënave të CSR dhe sqarohen përmes departamenteve relevante të grupit.



Tabela e përmbajtjes

1. Për Sharrcem

- 1.1 Historiku
 - 1.2 Shkurtimisht për vitin 2012
 - 1.3 Shkurtimisht për Titan Group
-

2. Mesazh nga Drejtori Menaxhues

3. Boshtet Strategjike të Titan Group

- 3.1 Vlerat Tona dhe Politika e CSR
 - 3.2 Organizimi i CSR
 - 3.3 Hisedarët tanë
 - 3.4 Plani i Veprimit 2012
 - 3.5 Qëndrueshmëria përmes sistemeve të certifikuara
-

4. Rrjeti i CSR në Kosovë

5. Punëtorët tanë

- 5.1 Shëndeti dhe siguria para së gjithash
 - 5.2 Aftësimi
 - 5.3 Aktivitetet e SH&SP dhe investimet
 - 5.4 Përmirësimi i vazhdueshëm i burimeve njerëzore
-

6. Komuniteti lokal

- 6.1 BKLP (Bordi Këshillëdhënës Lokal i Pavarur)
 - 6.2 Aktivitetet e Komunitetit
-

7. Mjedisi

- 7.1 Performanca Mjedisore
 - 7.2 Vetëdija e Mjedisit të Ndërtimit
-

8. Tabela e Shpjegimit të GRI

1. Për Sharrcem

1.1 Historiku

Sharrcem është themeluar në vitin 1936 i përbërë nga një furrë vertikale me kapacitet prodhimi prej 4,415 ton në vit. Sharrcem është përvetësuar nga TITAN Group në vitin 2010, përmes procesit të privatizimit në Kosovë. Është fabrika e vetme e çimentos në vend, që gjendet në kufi me Maqedoninë. Në vitin 2010 Sharrcem u bë anëtar i TITAN Group dhe vazhdon të jetë furnizues kryesor i çimentos në Kosovë.

Një vit pas marrjes nga TITAN Group, Sharrcem avancoi dukshëm teknologjinë e vet dhe teknikat për prodhim të lëndës së parë dhe çimentos dhe ka filluar zbatimin e standardeve të larta të integruara në të gjitha nivelet e punës.

1936

Themelohet fabrika e Sharr Cementit.

1972

Avancimi i parë i fabrikës me një furrë rrotulluese dhe ftohës satelit, kapaciteti rritet në 180,000 ton në vit.

1980

Bëhet një investim i ri për rritje të mëtejme të kapacitetit të furrës rrotulluese.

2000

Sharrcemi përfshihet në planin shtetëror të privatizimit dhe fillon një fazë qiradhënie prej dhjetë vitesh.

2010

Titan Group merr Sharrcemin dhe lanson një program ambicioz modernizimi për plotësimin e standardeve ndërkombëtare në cilësi, teknologji dhe mbrojtje mjedisi.

2011


Sharrcem merr rol udhëheqës në themelimin e rrjetit CSR të Kosovës dhe zotohet të angazhohet me hisedarët kyç, derisa investimi për modernizim është në ritëm të plotë.

2012

Sharrcem përmbyllë fazën e parë të avancimit teknologjik dhe përmirëson efikasitetin e vet dhe ndikimin mjedisor. Fabrika certifikohet për herë të parë për cilësi (ISO 9001) dhe zbaton Sistemin e menaxhimit të CO2. Kompania kryesisht i shërben tregut të Kosovës, me shitje në disa raste edhe në Maqedoni e Serbi.



1.2 Shkurtimisht për vitin 2012



1.3 Shkurtimisht për Titan Group

TITAN Group është një prodhues i pavarur, i integruar vertikalisht, i çimentos dhe materialeve ndërtimore me 110 vite përvojë në industri. Me zyrë qendrore në Greqi, TITAN grup ka në pronësi fabrika çimentoje në 9 vende dhe ka të punësuar më shumë se 5,500 punëtorë në tërë botën. Prodhimet kryesore përfshijnë çimento, beton, aggregate, blloqe ndërtimi, ProAsh® etj. Prodhimet e TITAN shërbejnë për nevojat themelore të shoqërisë dhe cilësitë e tij përfshijnë sigurinë, qëndrueshmërinë, efikasitetin e burimeve, lidhshmërinë, si dhe kursimet dhe estetikën. Në vitin 2012,

mbulimi gjeografik i TITAN Group u shtri edhe më tej me instalimin e teknologjive të para të separacionit, pajisjen për ndarjen e hirit në një fabrikë të një klienti në Azi (Koreja e Jugut). Gjatë vitit TITAN gjithashtu ka zgjeruar fushëveprimin e vet me themelimin e një kompanie të re për zgjidhje mjedisore, GAEA si një ndërmarrje e përbashkët me kompaninë amerikane, Evoluimi Mjedisor (E2). Përkushtimi i Grupit TITAN ndaj Qëndrueshmërisë dhe CSR është demonstruar në politikat dhe praktikën e tyre si edhe përmes pjesëmarrjes aktive në iniciativë

ndërkombëtare. TITAN ka qenë kompania e parë në Greqi që ka nënshkruar Global Compact të Kombeve të Bashkuara që ka për synim të ruajë të drejtat njerëzore, të drejtat e punës, mbrojtjen e mjedisit si dhe për të luftuar ryshfetin dhe korrupsionin. Është anëtar i qendror në CSR Evropë dhe në Këshillin Biznesor Botëror për Zhvillim të Qëndrueshëm. Është gjithashtu anëtar i Federatës së Ndërmarrjeve Hellenic, Asociacionit të Ndërmarrjeve Minerare Greke, Odës Ekonomike dhe të Industrisë së Athinës dhe i Asociacionit të Çimentos Portland.



TË RËNDËSISHME NË 2012

Në vitin 2012, Titan Group shënoi:

110 vite nga themelimi i fabrikës së parë të TITAN në Elefsina

100 vite në berzën e Athinës

10 vite nga pjesëmarrja aktive në U.N. Global Compact

TITAN GROUP ËSHTË ANTAR I:



TITAN



2. Një mesazh nga Drejtori Menaxhues

Të nderuar hisedarë,

Viti 2012 ka qenë sfidues për pjesën më të madhe të botës meqenëse kriza financiare vazhdoi të rrisë shqetësimet dhe vështirësitë në vendet e zhvilluara dhe në ato në zhvillim. Nuk mund të na ikë nga vëmendja se shoqëritë janë përballur dhe vazhdojnë të përballen me përvojat të cilat janë menduar si diçka e të kaluarës.

Kjo ka të bëjë edhe me korporatën gjithash-tu.

Në Sharrcem me të vërtetë jemi krenarë që kemi realizuar një program shumë kërkuar të modernizimit në vitin 2012, që ka ndryshuar tërësisht aspektin mjedisor të operacioneve tona biznesore si dhe potencialin tonë për zhvillim në të ardhmen. Përveç mjedisit, siguria dhe cilësia janë adresuar suksesshëm dhe sot kompania është tërësisht në përputhje me kushtet relevante të sektorit. Pa dyshim se kjo nuk ka qenë detyrë e lehtë, jo vetëm për shkak të kufizimeve nga mjedisi financiar ndërkombëtar por edhe si rrjedhojë e kufizimeve të tregut të brendshëm. Tregu vendor edhe pse me një kërkesë të madhe është ndikuar dukshëm nga zhvillimet në tregjet fqinje të cilat përballen me momente të vështira.

Megjithatë ne mbetemi të përkushtuar për të kontribuar në prosperitetin e vendit duke zhvilluar biznesin tonë në njërin anë duke u bazuar në standardet më të mira ndërkombëtare të industrisë dhe duke marrë iniciativë dhe përgjegjësi në drejtim të ngritjes së një tregu të drejt dhe transparent; ne konsiderojmë rritjen tonë të qëndrueshme vetëm kur shoqërohet nga një rritje proporcionale e komunitetit tonë dhe shoqërisë në përgjithësi. Sigurisht se jemi të vetëdijshëm për përpjekjet dhe fleksibilitetin e nevojshëm për këtë detyrë sfiduese. Komuniteti ynë vuan

nga shkalla e lartë e papunësisë, varfëria dhe mungesa e mbështetjes së strukturuar për zhvillimin e ndërmarrësisë. Ky ka qenë një objektiv strategjik i Titan Group në Kosovë dhe politikat e ndjekur nga Sharrcem-i theksojnë zotimin për të arritur këtë synim. E kaluara e Titan Group përveç se është një burim i vazhdueshëm frymëzimi, gjithashtu ka udhëhequr politikat tona dhe i ka shtuar vlerën dhe përvojën nga qëndrueshmëria dhe angazhimet në qeverisje, qoftë me Global Compact, GRI apo Këshillin Botëror të Biznesit për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Iniciativën për Qëndrueshmërinë e Çimentos.

Pas kryerjes së fazës së parë të avancimeve, që është, (a) eliminimi rreziqeve nga emetimet afatgjata nga operacionet e Sharrcem-it me një sistem të monitorimit të vazhdueshëm, (b) zbatimin e një laboratorit të plotë modern me automatizim modern dhe sisteme të TI-së për të pasur një monitorim të plotë në kohë të vërtetë të të gjitha proceseve të prodhimit, (c) zbatimi dhe auditimi vullnetar vjetor i menaxhimit të sistemit të CO2 dhe ISO 9001, në vitin 2012 kemi organizuar një forum të hisedarëve për prezantimin e strategjisë sonë të CSR dhe kemi ftuar hisedarët të japin informata kthyesa.

Dita e parë e hapur ka qenë një mundësi unike për të ftuar hisedarët lokalë së bashku me punëtorët tanë dhe familjet e tyre, mediat dhe autoritetet kombëtare për të vizituar fabrikën tonë dhe të ndjejnë ndryshimet që janë bërë për një Sharr të Gjelbër. Gjatë vitit 2013 Sharrcem do të marrë certifikimet në siguri (OHSAS 1800) dhe mjedis (1400) ku që të dyja janë duke u zbatuar që nga qershori 2012. Gjithashtu parashohim të marrim licencën e IPPC-së së integruar, njëri nga të parët nëse jo të parët në Kosovë. Ende kemi shkuar një hap më tej dhe kemi



ftuar hisedarët lokalë që të marrin pjesë në një bord këshillëdhënës lokal. BKL fuqizuar me misionin për të gjykuar dhe vendosur në mënyrë të përbashkët për propozimet e pranuar për kontribute financiare apo tjera të Sharrcem-it. Kjo është një qasje inovative drejt plotësimit në mënyrë më efektive të nevojave të komunitetit tonë me burimet që ne vejmë në dispozicion për përmirësimin e mirëqenies së tyre. Edhe pse kjo është një përpjekje e re, ne ndjehemi të sigurt se kjo do të adresojë më së miri sfidat lokale me anë të një konsensusi të gjerë dhe caktimit të drejtë të prioritetëve, dhe prandaj të avancimit të faktorit të qëndrueshmërisë afatgjate të zhvillimit të komunitetit tonë.

Të nderuar hisedarë,

Në emër të Komitetit të CSR së Sharrcem-it, task forcës së CSR dhe të gjithë punëtorëve tanë, me krenari paraqes këtë raport vjetor të parë të CSR të cilin më së miri do ta përshkruaja si një ftesë të hapur për krijimin e një hapësire për bashkëveprim dhe shkëmbim të opinionëve dhe vlerësimeve. Le të jetë një vegël që na ndihmon të kombinojmë fokusin dhe interesat tona për të kontribuar në mënyrë efektive për një rritje të përbashkët ndërmjet biznesit dhe shoqërisë.

Sinqerisht,

Emmanuel Mitsou,
Drejtor Menaxhues

3. Boshtet Strategjike të Titan Group

4 Boshte Strategjike:

Lloj llojshmëria gjeografike

Ne zgjerojmë bizneset tona dhe fuqizojmë portfoliot e aseteve tona përmes përmes blerjeve dhe krijimit të fabrikave të reja në tregje të reja tërheqëse.

Përmirësimi i vazhdueshëm i mundësisë konkurruese

Ne vazhdimisht përpiqemi të përmirësojmë strukturën e shpenzimeve tona dhe për të avancuar pozicionin tonë konkurrues duke investuar në bazën e aseteve tona dhe duke implementuar metoda dhe procese të reja në tërë biznesin tonë.

Integrimi vertikal

Ne shtrijmë aktivitetet tona në të gjitha produktet e materialeve të rënda ndërtimore, në zinxhirin e vlerave të tyre, duke krijuar shumëllojshmëri më të madhe, duke pasur qasje në mundësi të reja biznesi dhe duke adresuar nevojat e konsumatorit të fundit.

Fokusi në kapitalin njerëzor dhe CSR

Ne zhvillojmë dhe vazhdimisht përmirësojmë marrëdhëniet tona të mira me të gjithë hisedarët e brendshëm dhe të jashtëm në bazë të respektit dhe mirëkuptimit reciprok.

Duke ndjekur vlerat dhe strategjinë e TITAN Group, Sharrcem është zotuar të mishërojë CSR-në në strategjinë, politikën dhe praktikën e veta nga dita e parë e marrjes nga TITAN Group.

Për arritjen e këtij synimi, Sharrcem ka ndërmarrë rolin udhëheqës në nivel nacional, duke ngritur vetëdijen tek hisedarët kryesor dhe duke zbatuar transparencë dhe integritet në marrëdhëniet me punëtorët, partnerët e biznesit, komunitetin lokal, autoritetet dhe të gjitha palët e interesuara. Për arritjen e këtij synimi, Sharrcem ka themeluar një Komitet për CSR në përbërje nga 12 anëtarë.

Komiteti është përgjegjës për udhëheqje të zhvillimit të planit të veprimit të CSR dhe për shqyrtimin e informatave kthyes nga hisedarët, ashtu që të promovohet vetë-përmirësimi i vazhdueshëm në të gjitha nivelet. Siç prezantohet në diagramin në vijim, anëtarët e komitetit të CSR dhe të task forcës përfaqësojnë të gjitha funksionet e kompanisë dhe nivele menaxheriale të ndryshme.



Në vitin 2012 Sharrcem është shpërblyer me çmimin si "Tatimpaguesi i vitit 2011" nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë dhe "Shpërblimin për Biznesin më të Mirë" si certifikatë e prezantuar nga UNDP dhe Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë

3.1 Vlerat Tona dhe Politika e CSR

Si prodhues i materialit ndërtimor, produktet tona u kontribuojnë vlerave të shumëfishta shoqërore që ofrohen nga struktura konkrete siç janë siguria, qëndrueshmëria, ekonomia, efiquencia e burimeve dhe lidhja e njerëzve. Në të njëjtën kohë ne kuptojmë se operimet tona kanë ndikim në mjedis dhe në komunitetet fqinje. Ne zotohemi se do të reduktojmë këto ndikime duke “bërë më pak dëm”. Në përpjekjet tona për të bërë më pak dëm ne njohim faktin se ka mundësi fito-fito të cilat synojmë t’i ndjekim. Ne do të vazhdojmë të synojmë qëllimet tona të biznesit në një mënyrë të përgjegjshme për shoqërinë, duke

i kontribuar mirëqenies së punëtorëve tanë, familjeve të tyre, komuniteteve fqinje dhe shoqërisë në përgjithësi, thënë shkurt duke “bërë më shumë mirë”.

Zotimi ynë i CSR nuk është vetëm një përpjekje etike, por edhe një praktikë e krijimit të vlerave në bërjen e biznesit, duke avancuar reputacionin tonë, duke e fuqizuar licencën tonë të operimit dhe duke përmirësuar mundësitë konkurruese. Po aq me rëndësi është burimi i krenarisë dhe motivimit për njerëzit tanë, duke i shtuar mundësisë sonë për të tërhequr dhe mbajtur njerëz të mirë. Ne konsiderojmë angazhimin tonë në CSR si një proces proak-

tiv dhe të vazhdueshëm të vet-përmirësimit dhe mësimit të vazhdueshëm, duke iu përshtatur një biznesi kompleks që gjithnjë ndryshon dhe mjedisit shoqëror. Thelbësore në këtë përpjekje është të dëgjuarit, angazhimi, komunikimi si dhe ndërtimi i besimit reciprok me hisedarët tanë. Politika jonë e CSR synon të mishërojë qëndrueshmëri në organizim derisa në të njëjtën kohë të mbështesë një bilanc më të mirë të interesave afatgjata dhe afatshkurtra, në përshtatje të politikave dhe praktikave sipas nevojave të tregut lokal dhe prioriteteve dhe ecjes së qëndrueshme nëpër zinxhirin e vlerave.



TITAN është grup kompanish të integruara vertikalisht, aktive në industrinë e çimentos dhe materiale tjera ndërtimore të rënda, që operojnë në katër rajone dhe të zotuarat për të “...ndjekur gjithmonë synimet tona të biznesit dhe në krijimin e vlerave, në mënyrë etike dhe me përgjegjësi shoqërore, duke bërë më pak dëm dhe duke u përpjekur për të bërë më shumë mirë”



Politika e CSR e TITAN Group

“Për të ndjekur gjithmonë synimet tona të biznesit dhe në krijimin e vlerave, në mënyrë etike dhe me përgjegjësi shoqërore, duke bërë më pak dëm dhe duke u përpjekur për të bërë më shumë mirë”

Për të arritur vizionin tonë

- Praktika jonë e biznesit udhëhiqet dhe bazohet në Vlerat tona Titan dhe në kodin tonë të mirësjelljes.
- Siguria është prioriteti ynë më i lartë në biznes me qëllim të arritjes së një mjedisi të lirë nga aksidentet dhe incidentet.
- Jemi të zotuar për një rritje të qëndrueshme, integrimin elementeve

njerëzore, mjedisore dhe shoqërore në vendimet tona të biznesit.

- Ne synojmë përmirësimin e vazhdueshëm të performancës sonë sociale, matjen e ndikimit dhe kontributeve dhe vlerësimin e ndikimit tonë mjedisor dhe shoqëror.
- Synojmë në ndërtimin e besimit me të gjithë hisedarët tanë duke komunikuar hapur dhe në mënyrë transparente, dhe duke kërkuar angazhim për të kuptuar ndikimin e operimeve tona dhe shqetësimet e tyre.
- Ne ndajmë përvojën tonë, dijen dhe praktikën me të mira në fushat relevante të biznesit tonë për t’i shtuar vlerën dhe kontributin për mirëqenien e komuniteteve tona fqinje.
- Ne vlerësojmë punëtorët tanë dhe u përmbahemi praktikave të burimeve


njerëzore që promovojnë mundësi të barabarta në rekrutim, punësim dhe zhvillim, pa marrë parasysh gjininë, origjinën etnike, fenë etj. Duke respektuar individualitetin dhe duke qenë konsistent me ligjet nacionale dhe udhëzimet ndërkombëtare në mënyrë vullnetare, siç është Deklarata Universale e KB-së për të Drejtat e Njeriut.

- Ne merremi me zinxhirin tonë të furnizimit në përputhje me Kodin e Sjelljes së Prokurimit të Grupit tonë dhe atë Regjional.
- Në mënyrë vullnetare angazhohemi dhe mbështesim partneritetet dhe rrjetet e biznesit që promovojnë synimet tona të biznesit dhe vizionin e CSR, siç janë KB Global Compact, WBCSD/CSI, Aleanca e

BE-së për CSR, Iniciativa e SHBA-ve e Përbashkët për Qëndrueshmëri të Betonit etj.

- Ne synojmë të jemi aktiv në përpjekjet qytetare dhe në procesin e avancimit të përdorimit të produkteve tona dhe për të ruajtur qëndrueshmërinë afatgjate dhe prosperitetin ekonomik të industrisë sonë.
- Ne inkurajojmë dhe njohim iniciativën individuale dhe vullnetarizmin në komunitet dhe aktivitetet qytetare në të gjitha nivelet e punëtorëve, që ndërlidhen apo jo me biznesin tonë.
- Jemi të zotuar që të sigurojmë ofrimin e raporteve tona të praktikave të CSR në mënyrë periodike.

3.2 Organizimi i CSR



Prioritetet kryesore

- Identifikimi dhe komunikimi me hisedarët
- Angazhimi me hisedarët kryesor
- Fokusi në çështjet materiale të komunitetit
- Mbështetja dhe kontributi për rrjetin e CSR në Kosovë
- Plotësimi i standardeve të larta të qëndrueshmërisë përmes sistemeve të certifikuara

Parimet e Punës

Prioritetet kryesore të Komitetit të CSR janë themelimi i parimeve në Sharrcem përmes krijimit të politikave të duhura të CSR dhe strategjisë e cila do të mund të perceptohej mirë nga i tërë komuniteti i hisedarëve.

1. Vendosja për politikat dhe projektet e CSR
2. Raportimi i CSR
3. Vetë vlerësimi
4. Angazhimi me Komunitetin Lokal
5. Koordinimi i Rrjetit të CSR

Pas rezultateve të vitit 2012 Komiteti i CSR u pajtua për vazhdimin e përpjekjeve të tyre për angazhimin e hisedarëve dhe për të rritur kontributet e komunitetit në vitin 2013 me anë të:

- Forumit të angazhimit të hisedarëve
- Menaxhimit të kontraktuesve
- Themelimit të inkubatorit të biznesit

Pas rekomandimeve të Ndërmarrjes 2020, Sharrcem do të përpikët me iniciativa inovative të inkuorpuara përmes themelimit të inkubatorit të biznesit për krijimin e vendeve të reja të punës në komunën e Hanit të Elezit, dhe për këtë arsye të bëhet përmirësimi i qëndrueshëm i zhvillimit ekonomik në zonat përreth. Për koordinim më të mirë të prioritetëve lokale dhe synimet me zotimet dhe synimet e Grupit, si dhe me renditjen e vazhdueshme të politikave dhe praktikave të Sharrcemit me standardet ndërkombëtare për performancën sociale dhe mjedisore, është formuar gjithashtu një Task Forcë e koor-

dinimit të CSR në përbërje prej 6 anëtarësh të Komitetit të CSR siç përshkruhet në faqen në anën tjetër.

Është ndërmarrë një përpjekje shtesë që nga nëntori 2011, ashtu që të inkurajohet përfshirja dhe bashkëpunimi me hisedarët lokal në kornizën e zbatimit të Politikës së CSR.

Komiteti i CSR i kompanisë ka ftuar grupet lokale të hisedarëve për të emëruar përfaqësuesin e tyre në Bordin e Pavarur Këshillëdhënëse Lokale (BPKL), qëllimi kryesor i të cilit është mbështetja dhe lehtësimi i bashkëpunimit ndërmjet Sharrcemit dhe komunitetit lokal në zhvillimin e projekteve.

3.3 Hisedarët tanë

Dëgjimi dhe përgjigja ndaj brengave të hisedarëve tanë bashkëpunëtorë konsiderohet si forca bartëse në përpjekjet tona për të përmbushur në mënyrë efektive sfidat e përgjegjësisë së korporatës. Më tej, është i nevojshëm informacioni kthyes nga hisedarët për përmirësim të vazhdueshëm. Identifikimi i hisedarëve kryesor është një proces i bashkërenditur me standardet ndërkombëtare. Trajnime dhe punëtori relevante ofrohen për menaxherët e kompanisë për të lehtësuar këtë proces si një pjesë përbërëse në vazhdimësinë e operimit.

Duke zbatuar parimet e afërsisë, ndërlidhjen dhe materializimin, Sharrcem ka përfshirë punëtorët, komunitetin lokal, klientët, furnitorët, shoqërinë civile dhe autoritetet qeveritare në listën e hisedarëve kryesor.

Që nga viti 2010, janë zbatuar një numër iniciativash për inkurajimin e një dialogu ndërmjet hisedarëve dhe për të kërkuar informatat kthyesë në lidhje me çështjet materiale, siç është ndikimi mjedisor apo operimet dhe se si Sharrcem është bërë "më i gjelbër".

Si pjesë kryesore e rregullave tona të CSR për angazhim kemi bërë një identifikim fillestar të hisedarëve tanë lokal dhe nacional:

*Punëtorët,
Komuniteti lokal
Konsumatorët, furnitorët dhe kontraktuesit,
Investuesit,
Qeveritë,
OJQ-të,
Sindikatat etj.*

Sharrcem është anëtar i:



3.3 Hisedarët tanë | Vazhdim

Meqenëse Kosova është një vend i ri si i pavarur, ende është duke u përballur me sfida strukturore dhe rregullative për kornizën e vet sociale dhe ekonomike. Veç kësaj, fakti se ka një aktivitet mjaft të kufizuar industrial në përgjithësi, dhe rezultati e bën operimin tonë njërin nga më të rëndësishmit në tërë territorin. Si rrjedhojë, kemi identifikuar si hisedarë kyç jo vetëm palët që ndërlidhen me biznes dhe komunitetin më të afërt me të cilin operojmë, por më tej subjektet - publike, jo fitimprurëse apo private të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në formimin e mjedisit biznesor në Kosovë në kuptimin e tij të gjerë. Një pjesë e mirë e hisedarëve të identifikuar tashmë janë kontaktuar nga task force e CSR së Sharrcemit me qëllim të komunikimit të planeve të veta për përgjegjësinë përkatëse sociale dhe për veprimet. Sharrcem do të vazhdojë me këto komunikime përmes angazhimeve ad hok, publikimeve dhe takimeve specifike për projekte.

1	Punëtorët e Sharrcemit	Nr. 502	26	Universiteti i Prishtinës
2	Furnitorët dhe kontraktuesit (përfshirë personelin në fabrikë)	Nr. Përafërs. 350	27	AUK - Universiteti Amerikan i Kosovës
3	Komuna e Hanit të Elezit		28	Oda Ekonomike e Kosovës
4	Shoqëritë lokale fetare		29	Oda Amerikane Ekonomike në Kosovë
5	Institucionet lokale arsimore		30	Oda Gjermane Ekonomike në Kosovë
6	Institucionet lokale shëndetësore		31	Aleanca Kosovare e Bizneseve
7	Asociacioni lokal i Invalidëve të Luftës		32	Bashkëpunimi Gjerman / GIZ, KfW
8	Komuniteti lokal i biznesit		33	Bashkëpunimi Zviceran / SDC
9	Zyra lokale e autoriteteve doganore		34	ADA - Agjencia Austriake e Zhvillimit
10	Stacioni policor lokal		35	DANIDA - Agjencia Daneze për Zhvillim Ndërkombëtar
11	RDA - Agjencia për Zhvillim Rajonal - Lindje		36	SIDA - Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar
12	Ministritë dhe Autoritetet Publike Qendrore		37	NORAD - Agjencia Norvegjeze për Zhvillim e Bashkëpunim
13	QRP-të - Qendrat Rajonale të Punësimit		38	Rrjeti i PSK-së në Kosovë
14	Handikos		39	QIK - Qendra e Inovacionit në Kosovë
15	UNDP		40	FKSHC - Fondacioni Kosovar i Shoqërisë Civile
16	UNICEF		41	IZHK - Iniciativat e Zhvillimit të Komunitetit
17	FAO - Organizata për Bujqësi dhe Ushqim		42	FES - Friedrich Ebert Stiftung
18	OSBE - Misioni në Kosovë		43	GAP - Instituti për Studime të Avancuara
19	Zyra e BE-së në Kosovë		44	IBQ - Instituti për Bashkësi të Qëndrueshme
20	Zyra ndërlidhëse Greke		45	QKE - Qendra Kosovare për Edukim
21	Ambasada Gjermane		46	Riinvest
22	Banka Botërore		47	KFOS - Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur
23	IFC - International Finance Co.		48	Helvetas Swiss inter-cooperation
24	BERZH - Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim		49	NOA Kos - Mundësi të reja në Bujqësi
25	UNKT Ekipi i Kosovës nga Kombet e Bashkuara / ILO, UNESCO, UNIDO, UN Gratë		50	Care Kosova
			51	KAEF - Fondi Amerikan për Edukim në Kosovë

Politika e furnitorëve

Furnitorët, përfshirë kontraktuesit janë një pjesë kritike dhe e drejt-përdrejtë e krijimit të veprimtarisë së biznesit në rajon dhe prandaj Sharrcem ka një politikë të qartë përmes procedurave të prokurimit dhe rekrutimit në dhënien e preferencës për faktorin lokal.

Furnitorë	Nr.	Qarkullimi %
Të huaj	178	60,9
Vendor	201	39,1
(Prandaj Vendorët)	53	42,3

3.4 Plani i Veprimit 2012

VEPRIMI	FUSHA E KONTRIBUTIT				LOKACIONI
	Mjedisi	Investime sociale	Punësimi dhe Arsimi	Shëndeti dhe Siguria	
Hiri fluturues					Prishtina
Piriti (Oksidi i hekurit) <i>Çështja e mjedisit</i>	✓				Lokacione të ndryshme
Karburantet alternative <i>Trajtimi i mbeturinave komunale, Linjiti, Biomasa</i>	✓	✓	✓	✓	Ferizaj, Kacanik, Gjilan
Linjiti <i>Zëvendësimi i karburantit të importuar</i>		✓	✓		Lokacion minerar
Impiant i trajtimit të ujit <i>Lidhja në sistemin e kanalizimit</i>	✓	✓	✓	✓	Hani i Elezit
Sanitari - furnizim me ujë <i>Furnizimi kryesor për ekonomi familjare</i>				✓	Hani i Elezit
Rregullimi i brixhëve të lumit <i>Zgjerimi/plotësimi i projektit</i>	✓	✓		✓	Hani i Elezit
Ndriçimi, trafiku dhe rregullimi urban <i>Përmirësimi i kushteve - rrugët</i>		✓		✓	Hani i Elezit
Hulumtime për potenciale të reja biznesore (përfsh. NMV) <i>Krijimi i aktiviteteve të reja</i>		✓	✓		Hani i Elezit, Kacanik
Arsimi <i>Specialist të materialeve ndërtimore (bursa-grante)</i>			✓		Hani i Elezit, Kacanik
Bordi këshilldhënës lokal	✓	✓	✓	✓	Hani i Elezit, Kacanik
Në çka mund të rezultojnë politikat efektive:	FUSHA E KONTRIBUTIT				Location
	Mjedisi	Investime sociale	Punësimi dhe Arsimi	Shëndeti dhe Siguria	
Me krijimin e një politike e cila parasheh që ndikimet e mjedisit nuk mund të trajtohen nga subjektet që prodhojnë ato, të cilat duhet të vendosen në përdorim efektiv industrial për të minimizuar ndikimin e tyre në mjedis dhe në të njëjtën kohë ndihmohen subjektet industriale për (i) zvogëlimin e kostos (ii) për të siguruar furnizimin, dhe (iii) për të parandaluar ata nga eksportimi i substancave të tilla jashtë vendit Cdo dy apo tri vite subjektet kryesore të industrisë dhe/apo institucionet e administratës do të kryejnë studime dhe ftojnë për propozime nga komuniteti për projekte të NMV-ve dhe bizneseve nga të cilat komuniteti përfiton. Idetë do të degjoheshin nga një bord në përbërje nga një përfaqësues biznesi, një përfaqësues komunal dhe një organizatë neutrale siç është AmCham apo Rrjeti i PSK-së. Me fjalë tjera, krijimin e një inkubatori të biznesit të përshtatur dhe fokusuar në nevojat reale të shoqërisë lokale. Vetëdijësimi gradual për sigurinë dhe rritja e perceptimit për varësinë e madhe ndërmjet veprimtarisë profesionale dhe standardit jetësor, të mos përmendet më pak aksidente (apo masa për parandalim më të madh) është e barabartë me më pak shpenzime në llogarit të shëndetit publik.					
Në tërë vendin					

3.5 Qëndrueshmëria përmes Sistemeve të Certifikuara

Sipas politikës së Titan, Sharrceci ka filluar me zbatimin e Sistemeve Ndërkombëtare dhe Evropiane të Sistemeve të Menaxhimit të Certifikuar.

Departamenti i cilësisë në Sharrcem është i prerë sa u përket kushteve të standardeve për analiza kimike dhe mekanike të çimentos dhe llaçit, ashtu që të sigurohet një cilësi e lartë për konsumatorët e tyre gjë që konsiderohet thelbësore për këto produkte kritike për industrinë e ndërtimit.

Duke u bazuar në këto zotime të Menaxhmentit, Sharrcem është certifikuar me Normat Evropiane ISO 9001-2008 për sistemin e menaxhimit të cilësisë në të gjitha proceset e veta, me fokus të veçantë në laboratorin e vet, i cili në vitin 2012 është pajisur me instrumentet më të avancuara për analiza kimike dhe mekanike gjë që garanton klientët tanë për produkte cilësore. Laboratori është i akredituar për testimin e çimentos në pajtim me ISO/ IEC 170725 nga Drejtoria e Akreditimit në Kosovë.



Që nga viti 2011, Sharrcem ka plotësuar certifikimin për ISO 9001 që ndërlidhet me cilësinë e produkteve dhe shërbimeve, derisa në mënyrë intensive përgatitet për ISO 14001 që ndërlidhet me sistemet e menaxhimit mjedisor dhe OHSAS 18001 që ndërlidhet me sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë. Që të dyja tashmë janë themeluar dhe certifikimi pritet të bëhet kah fundi i vitit 2013.

FUSHA	Sistemi Mnxh. / Certifikimi	Statusi
Të gjitha produktet / llojet e çimentos	CEM IV/B (P-W) 32.5R	✓
	CEM II/B-M (W-L) 42.5R	✓
	CEM I 52.5N	✓
	MC 5 Sharrmall	✓
Emetimi i CO2	Sistemi i menaxhimit të CO2 sipas protokollit WBCSD	Zbatuar në 2011 / Audituar në 2012
Cilësia	ISO 9001	✓
Mjedisore	ISO 14001	Zbatuar / Audituar në 2013
Mjedisore	IPPC	Në fund të 2013
Siguria	ISO 18001 / OHSAS	Zbatuar / Certifikuar në fund të 2013
Llogaridhënia	SA 8000	Planifikuar për 2014
Financa	Auditimi vullnetar në mes të vitit	✓

Cilësia e Produktit

Sharrcem ka një proces të brendshëm të dokumentuar për trajtimin e ankesave për cilësinë e produktit. Procedura shtrinë hetimet në prodhim - kohë - regjistrim dhe kërkon dokumentacionin nga raportet ditore të prodhimit duke përfshirë edhe shitjen, në departamentin e cilësisë dhe të prodhimit. Ankesat trajtohen pastaj me anë të ofrimit të produktit apo shërbimit. Nuk ka pasur ndonjë mospërbushje gjatë vitit 2012.

4. Rrjeti i CSR në Kosovë



Në prill 2011 Sharrcem ka qenë në mesin e anëtarëve themelues të Rrjetit të CSR në Kosovë, një asociacion jo qeveritar dhe jo fitim prurës që ka për synim rritjen e vetëdijes së bizneseve për nevojën për një sjellje proaktive në drejtim të komunitetit dhe mjedisit. Rrjeti i CSR punon në drejtim

të përmbushjes së plotë të dhjetë parimeve të Global Compact të cilat u referohen të drejtave njerëzore, punës, mjedisit dhe anti-korrupsionit. Të gjithë anëtarët e rrjetit kosovar të CSR janë të lidhur në mënyrë vullnetare, dhe në mënyrë aktive angazhohen në parimet e CSR.

Më tej, Sharrcem ka mbështetur plotësisht bashkëpunimin më të ngushtë ndërmjet Rrjetit kosovar të CSR dhe CSR në Evropë, rrjetin udhëheqës të CSR në biznes në Evropë dhe me avokimin e BE-së për CSR dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Në vitin 2012 rrjeti kosovar i CSR u bë anëtar i CSR Evropës. Sharrceci mbanë një përfshirje të fuqishme dhe aktive në rrjet që prej ditës së parë.

Rrjeti kosovar i CSR sot ka në total 14 anëtarë. (Më shumë informacione mund të gjenden në www.csrkosovo.org). Sharrcem mban selinë e bordit të rrjetit që nga fillimi.



Anëtarët e Rrjetit Kosovar të CSR



Robert Wright - shëf ekzekutiv në Raiffeisen Bank dhe Kryesues i Rrjetit Kosovar të CSR

Në rolin tim si shëf ekzekutiv i Raiffeisen Bank në Kosovë dhe si Kryesues i Rrjetit Kosovar të CSR, do të dëshiroja të shpreh falënderimin tim të singertë dhe vlerësimin tim për marrëdhëniet e shkëlqyeshme të punës dhe bashkëpunimin i cili ekziston me menaxhmentin e Sharrcem SH.P.K. - Kompania Titan Group që gjendet në Hanin e Elezit.

Si klient afatgjatë i besueshëm i Bankës dhe si anëtar themelues i Rrjetit CSR,

Sharrcem në mënyrë konsistente ka shërbyer si model i rolit për bizneset tjera në Kosovë se si duhet vepruar.

Ata gjithmonë kanë qenë shumë bashkëpunues, kanë dëshmuar zotim të madh për komunitetin e tyre lokal dhe gjithmonë operojnë plotësisht në linjë me vlerat dhe parimet e tyre të fuqishme.

Në veçanti ata kanë paraqitur shqetësimin e tyre të madh si dhe zotimin e tyre ndaj standardeve të shëndetit dhe sigurisë për punëtorët e tyre dhe komunitetin lokal dhe janë një shembull shumë i mirë për tërë Kosovën që mund të ndiqet. Mirëpres

vazhdimin e këtyre marrëdhënieve të shkëlqyeshme edhe për shumë vite tjera që vijnë.



RRJETI KOSOVAR I CSR KODI I ETIKËS SË ANËTARËSISË

“ _____ ” ZOTOHET PËR
PARIMET DHE PRAKTIKAT E PËRGJEGJËSISË SË KORPORATËS dhe përqafton
PARIMET E GLOBAL COMPACT TË KOMBEVE TË BASHKUARA. Ne pranojmë se
ato janë fundamentale dhe të qëndrueshme në afat të gjatë për këtë kompani.

Ne përpiqemi dhe punojmë për SHKËLQIM NË BIZNES në të gjitha fushat që
kanë NDIKIM TEK HISEDARËT TANË. Këto përfshijnë klientët tanë, punëtorët,
aksionarët, furnitorët, komunitetin dhe mjedisin.

Ne marrim përsipër të ANGAZHOHEMI NË KONSULTIME DHE DIALOG TË
HAPUR DHE TRANSPARENT me të gjithë hisedarët tanë në vazhdimësi.

Zotohemi që VAZHDIMISHT TË PËRMIRËSOJMË PRAKTIKAT E BIZNESIT TONË
përmes vlerësimit dhe të mësuarit dhe do të SHKËMBEJMË SHEMBUJ NGA
PRAKTIKAT MË TË MIRA PËR INSPIRIMIN E TË TJERËVE për të përqaftuar përg-
jegjësinë e korporatës dhe për të qenë qytetar i mirë i korporatës së.

Zotohemi të ndërmarrim veprimet e nevojshme për arritjen e objektivave të
kësaj karte.

Nënshkruar nga _____ më _____

Për “ _____ ”

5. Punëtorët tanë

“Fuqia jonë punëtore është burimi ynë më i vlefshëm. Respekti për të drejtat e tyre njerëzore, ofrimi i kushteve të sigurta, kushte të mira të punës pa diskriminim dhe me theks gjithashtu edhe në marrëdhëniet e punëtorëve, është prioritet për TITAN Group në arritjen e objektivave të veta.”

(Kodi i Mirësjelljes së TITAN Group)

Politikat e punësimit dhe prokurimit të Sharrcem janë të fokusuar kryesisht tek njerëzit

dhe bizneset nga komuniteti lokal. Bashkëpunimi është në zemrën e strategjisë së punëtorëve tanë që fokusohet në gjashtë fusha:

Puna së bashku: Mishërimi i një kulture bashkëpunuese dhe jo diskriminuese. Nuk janë regjistruar incidente diskriminimi.

Një mjedis pune i shëndoshë dhe i sigurt: Me fokus në sigurinë e njerëzve tanë dhe në promovimin e mirëqenies së tyre fizike dhe

mendore.

Një kulturë të hapur dhe të lloj llojshme: Angazhimi i punëtorëve tanë dhe promovimi i përfshirjes dhe diversitetit.

Mundësitë e Punëtorëve: Realizimi i potencialit të plotë të punëtorëve tanë përmes mundësive të zhvillimit dhe trajnimit.

Shpërblimi i njerëzve tanë: Shpërblimi i punëtorëve përmes performancës konkurruese me kompensim dhe benificione. Sharrcem është i përkushtuar t'u përmbahet parimeve të UN Global Compact (www.unglobalcompact.org).


Politika e rekrutimit: Procedurat e BNJ-së i japin preferencë rekrutimit vendor si përgjigje për problemin e papunësisë. Në vitin 2012 asnjë pjesëtar personeli nuk ka dhënë dorëheqje dhe 16 janë rekrutuar me kontratë të plotë punësimi (nga ta 12 vendorë)

Kualifikimi i punëtorëve

Me diplomë universiteti	41
Me diplomë të Shkollës së Lartë	14
Me shkollës të mesme	89
Të kualifikuar	245
Shkolla fillore	113

Struktura gjinore

Meshkuj:	484
Femra:	18



PUNËTORËT në Sharrcem / një Kompani e Titan Group		2012
Numri i punëtorëve me orar të plotë		502
Numri i punëtorëve me orar jo të plotë		0
Numri i plotë i punëtorëve		502
Numri i punëtorëve sipas gjinisë		
	#	%
Femra	18	3,6
Meshkuj	484	96,4


PAGAT MUJORE

	Kosovë	Sharrcem	
Minimumi	130 - 170 € ⁽¹⁾	293 €	⁽¹⁾ Dallimi nga paga Minimale aktualisht nën negociata
Mesatarja	300 - 400 € ⁽²⁾	768 €	⁽²⁾ Enti i Statistikave të Kosovës

Menaxherët lokal / Bordi i zgjeruar i menaxhimit

Të ardhur nga jashtë	8
Vendor	11
(Nga ata lokal janë)	5
TOTAL	19

5.1 Shëndeti dhe Siguria Para së Gjithash



Vizioni ynë -

të arrihet punë në ambient të shëndosh dhe sigurt me “Zero” lëndime dhe incidente.

Synimi ynë -

synojmë përmirësimin e vazhdueshëm të performancës sonë të SH&S-së duke menaxhuar atë si Synim i yni i parë i biznesit. Ne menaxhojmë SH&S-në si një sistem të integruar të synimeve me llogaridhënie dhe përgjegjësi të qarta.

Politikat tona -

ne përdorim ndikimin tonë më së miri që mundemi për të bindur furnitorët tanë, kontraktuesit dhe palët e treta për të adoptuar politika të ngjashme të SH&S-së. Për të përmirësuar në vazhdimësi politikat tona të shëndetit dhe sigurisë në të gjitha nivelet, në të gjitha fushat.

Si një industri e rëndë, ne vazhdimisht përpiqemi të themelojmë sjellje të sigurt dhe shëndoshë në tërë organizatën në aktivitetet tona të përditshme dhe për të krijuar një mjedis në të cilin secili, dhe të gjithë ne jemi përgjegjës për sigurinë tonë dhe të kolegëve tanë.

Ne sigurojmë identifikimin e të gjitha obligimeve ligjore sa i përket SH&S-së dhe i adresojmë ato në një mënyrë të kën- aqshme dhe definojmë të gjitha funksionet e nevojshme të SH&S-së që kërkohen nga legjislacioni nacional dhe lokal. Shëndeti dhe siguria është prioriteti i parë për Sharrcemin siç është për TITAN Group.

Përpyekjet tona janë të fokusuara në ngritjen e vetëdijes ashtu që të bëjmë maksi-

mumin për të ruajtur SH&S-në e të gjithë punëtorëve në mënyrë direkte dhe indirekte ku kemi kontroll menaxhimi.

Sharrcemi vazhdimisht punon për mishërimin e sjelljes së sigurt dhe të shëndoshë në tërë organizatën në aktivitetet tona të përditshme dhe për të krijuar një mjedis në të cilin secili, dhe të gjithë ne jemi përgjegjës për sigurinë tonë dhe të kolegëve tanë.

Masat e shëndetit dhe sigurisë aplikohen për punëtorët tanë, kontraktuesit, furnitorët si dhe për komunitetin lokal ku ne operojmë.

Mbajtja e aksidenteve në zero

Viti 2012 ka qenë një vit pa lëndime me humbje kohe (LHK) për Sharrcemin. Kjo ka qenë rezultat i përpjekjeve intensive dhe të vazhdueshme për avancimin dhe përparimin e mjedisit të punës, sistemeve të menaxhimit si dhe mentalitetit tonë dhe vetëdijes

për siguri.

Zotimi i Sharrcemit për këtë ka qenë dhe është mjaft mirë i vlerësuar. Është e vërtetë se synimi ynë për të shkaktuar ZERO dëme në njerëz duket të jetë ende larg, sidoqoftë ky synim do të jetë shumë më afër çdo ditë e më shumë. Këto statistika konfirmojnë përcaktimin e kompanisë që vazhdimisht të përmirësojë dhe mirëmbajë shëndetin dhe sigurinë.

Për Sharrcemin, shëndeti dhe siguria është prioriteti kryesor. Për mishërimin e kulturës së sigurisë që do të ofrojë për të gjithë punëtorët një qasje proaktive dhe preventive për aksidentet ku jemi të fokusuar në ngritjen e vetëdijes dhe trajnimin e punëtorëve tanë, kontraktuesit tanë, por edhe hisedarët tanë kryesor.


Për të filluar që çdo e enjte i ndahet trajnimit të sigurisë, një program i cili zbatohet nga Departamenti i Shëndetit dhe Sigurisë, dhe të gjithë punëtorët e kompanisë marrin pjesë.

Përmbledhje e incidenteve

Lëndim me humbje kohe (LHK)	0
Shpeshhtësia e (LHK-ve)	0
Niveli i ashpërsisë së (LHK-ve)	0

5.2 Aftësimi

Orët e trajnimit për person



Trajnimi i të enjtes tani më shumë traditë sesa program

Sharrcemi mbanë shëndetin dhe sigurinë si prioritet të parë me anë të trajnimit të secilit punëtor. Për këtë qëllim ne kemi zhvilluar programin e trajnimit të së enjtes i cili zbatohet nga departamenti i shëndetit dhe sigurisë dhe vijohet nga të gjithë punëtorët e kompanisë. Programi merr vlerësimin e fuqisë tonë punëtore çdo ditë dhe ne parashohim që ky të bëhet një gjen-erator i “Ideve të Sigurta” në një të ardhme të afërt.

Arritjet

Sistemi SH&S OHSAS ka filluar
në qershor 2012

Zero fatalitete apo aksidente
të rënda 2012

Standardet e përshtatura

Sharrcemi ka përshtatur dhe dokumentuar standardet e trajnimit të Titan Group. Këto standarde përfshijnë certifikime specifike për punë, literaturë të rifreskuar vazhdimisht, komunikim të praktikave më të mira (publikuar nga Grupi dhe Këshilli Botëror i Biznesit për Zhvillim të Qëndrueshëm / CSI) dhe masat efikase të SH&S-së përmes kontrolleve nga palët e treta. Trajnimet ofrohen nga departamenti i SH&S-së i Sharrce- mit dhe nga ekspertët e jashtëm.

5.3 Aktivitetet e SH&SP dhe Investimet

Inicimi i raportit të incidentit pa humbje


Raporti i incidentit pa humbje është një ngjarje e pa planifikuar që nuk ka rezultuar në lëndim, sëmundje apo dëmtim - mirëpo ka pasur mundësi të ndodh kjo. Një incident që ka mundur të rezultojë në humbje mund të raportohet nga ndonjë punëtor dhe duhet të regjistrohet në departamentin e SH&S-së. Çdo raport i incidentit pa lëndim krijon hapsirë për të menduar në mënyrë kritike, vetëdijesim për identifikimin e rreziqeve dhe përfundimisht për masat specifike të cilat përfshijnë një përmirësim gradual dhe përmirësim të përhershëm të sigurisë në punë.

Për të parandaluar incidentet e tilla që të mos ndodhin përsëri, organizata ka themeluar një aftësim të punës ekipore, informata kthyesë për performancën dhe një zotim për mbledhje të vazhdueshme të të dhënave dhe analizave, një proces që quhet përmirësim i vazhdueshëm.

Raportimi i incidenteve pa humbje tenton të zgjidhë drejt-përdrejt apo në mënyrë indirekte çështjet e sigurisë dhe ka si synim krijimin e një kulture të hapur me anë të së cilës secili ndan dhe kontribuon në mënyrë të përgjegjshme.

Raportimi i incidenteve pa humbje duket të ketë rritur marrëdhëniet e punëtorëve dhe inkurajon punën ekipore në krijimin e një mjedisi më të sigurt të punës.

Raportimi i Incidenteve pa Humbje



Planifikimi i Synuar SH&S

CAQET 2013	CAQET 2015
Kryerja e procesit të SH&S 18001 Certifikimi i Menaxhimit të Sistemit	Përmirësim i vazhdueshëm
Zero fatalitete dhe zero aksidente të rën.	Mbajtja në zero e fataliteteve dhe aksidenteve të rënda
Rënie e vazhdueshme në: Lëndime me humbje kohe (LHK) Shpeshtësinë e LHK-ve Shkallën e ashpërsisë së LHK-ve	Arritja dhe mbajtja në zero e LHK-ve dhe Incidenteve tjera
Rritja e raportimeve të incidenteve pa humbje > 64	Rritja e raportimeve të incidenteve pa humbje > 120

5.3 Aktivitetet e SH&SP dhe Investimet | Vazhdim

Fusha e investimit	Projekti	Statusi
Zjarrfikje	Rrjet i ri i hidranteve Izolim i kablllove	20% 70%
Demolimi i strukturave të pasigurta	Silos të ndryshëm Rezervuar Ndërtesa	} Pjesa e vjetër e fabrikës
Sistemi LOTO dhe VCS (Siguria elektrike)	Linja e Mullirit Linja e furrës Linja e mullirit të çimentos	Filluar Filluar Pranuar (20%)
MCC / CCR (Dhomat e kontrollit)	MCC e pasigurt e zëvendësuar me CCR të zgjeruar dhe avancuar	100%
Mulliri i çimentos #3	Shkatërrimi i bartësit të zgjyrës dhe demontimi i vinçit	Pjesa e përgjithshme (80%) Investimi për sistemet e reja të ushqyerjes (faza e dizajnit)
Parmakët / Rrethojat Mbrojtëse	Masat e mbrojtjes fizike planifikuar për 2012	100%
Ngritjet	Zvogëlimi i rrezikut të personelit në lartësi	100%
Trafiku për këmbësorë dhe automjete	Ri-dizajnimi i plotë i trafikut (automjetet dhe këmbësorët) + Masat mbrojtëse / shufrat	100%
Kantina + Tualeti	Riparimi i plotë i instalimeve me pajisje të duhura	100%
Siguria në punë	Sistem i integruar për lëshimin e lejeve të punës Zbatimi i EAM (Coswin 71)	95%

Kontraktuesit dhe Furnitorët

Sharrcemi është i interesuar në lidhje me Shëndetin dhe Sigurinë e kontraktuesve dhe furnitorëve gjithashtu. Ne i konsiderojmë ata si pjesë përbërëse dhe jetike e operacioneve tona, duke siguruar kështu standardet e duhura për shëndetin dhe sigurinë. Për këtë qëllim, në vitin 2012 kemi zhvilluar një proces të ri të menaxhimit të kontraktuesve i cili inkorporon Shëndetin dhe Sigurinë. Qëllimi i këtij procesi është të vendos një sistem të ri të menaxhimit të kontraktuesve nga aspekti i SH&S-së. Synimi i tij është të ngris vetëdijen e tyre ashtu që ata të mund të kuptojnë që performan-



ca e tyre e mirë në SH&S është gjithashtu edhe performancë e mirë e biznesit. Ne kemi organizuar trajnime dhe komunikime dhe orët e përgjithshme të trajnimit për vitin 2012 kanë qenë 2,124 orë.

Obligimi Kontraktues

Sharrcem ka themeluar një formë standarde të spastrimit të kontratës për të gjithë kontraktuesit dhe furnitorët që fizikisht hyjnë në fabrikë. Përveç kësaj, i gjithë personeli i kontraktuesve dhe furnitorëve është i obliguar të raportojë në zyrën e SH&S-së së fabrikës para nisjes së ndonjë pune brenda perimetrit të fabrikës.






Demolimi i strukturave të pasigurta

Ndërtesat në fabrikën e vjetër janë ndërtuar në dy periudha: në të 30-tat dhe në të 60-tat dhe nuk janë mirëmbajtur mirë prej atëherë.

Gjendja aktuale e elementeve strukturore të ndërtesave nuk ofron siguri të mjaftueshme dhe stabilitet sipas një raporti të vlerësimit të bërë me këtë qëllim përparitur nga Sharrcepi dhe kryer nga INTER-CONSTRUCTION Engineering nga Shkupi, Maqedoni në vitin 2011.

Kështu që rekomandimi ishte të hiqet e tërë infrastruktura e vjetër në këtë zonë, dhe kështu të eliminohet rreziku i madh nga hapësira e punës.


Në fakt pas fazës së parë të punëve demoluese, mbeten disa struktura jo-operuese; ato izolohen dhe nuk lejohet ndonjë qasje e personave apo veturave aty. Është paraparë një fazë tjetër demolimi për vitin 2013 i galerisë së materialeve në fabrikën e vjetër.



4 rezervuarë të karburantit:
Neutralizimi mjedisor dhe heqja



Linja e vjetër e furrës dhe galeria e trajtimit të materialit: demoluar dhe hequr



Ndërtesat e vjetra përfshirë furrat fillestare vertikale (30-tat) dhe depoja ndihmëse: demoluar dhe hequr

Zhvillimi i kulturës së sigurisë

Vetëdija e rritur në nivel të lartë të punëtorëve të kompanisë është një veti kyçe e një kulture sigurie të vazhdueshme e në zhvillim e sipër. Kërkohej përgjegjësi individuale jo vetëm për ata por edhe për kolegët, bashkëpunëtorët dhe të gjithë njerëzit e tjerë që ndërlidhen me Sharrce-min. Kjo ide ambicioze por e arritshme udhëheqëse, ku përfshihet e tërë organizata së bashku me operacionet në fushën e shëndetit dhe sigurisë është bërë përmes angazhimit të drejtpërdrejt të stafit të kompanisë.

Punëtorët janë të angazhuar në nën-komitetet e sigurisë, trajnimet, takimet tematike që kanë të bëjnë me çështjet dhe iniciativat e sigurisë. Gjatë vitit 2012 janë mbajtur disa takime të sigurisë me pjesëmarrje të bollshme të punëtorëve. Janë diskutuar tema të rëndësishme (hetimi i incidenteve, veglat, pajisjet, procedurat), që ndërlidhen me politikat e përgjithshme të sigurisë së kompanisë. Me futjen e sistemit të menaxhimit të aseteve të ndërmarrjes (EAM / Coswin i7) që nga janari 2012, kompania tashmë ka specifikuar në procedurat e veta në të gjitha punët e që ndërlidhen me sigurinë dhe lejet për të supozuar miratim të dokumentuar në secilën punë. Të gjitha “porositë e punës” dhe “lejet e punës” janë pjesë e sistemit.

Në Sharrcem, përveç komitetit të SHS-së ku marrin pjesë shtatë punëtorë, janë themeluar 6 nën-komitete të SHS-së dhe janë duke operuar me pjesëmarrjen e numrit të përgjithshëm prej 20 punëtorësh.

Në TM IV 2012, kompania ka caktuar një kontratë ISCI për ofruesin specialist Management Force Group LLC me synim të avancimit të kulturës operacionale të

sigurisë; Ky program trajnimi i përkushtuar krijon ndër tjera ndër punëtorë një ide përcjellëse të ndjeshmërisë së avancuar në fushën e identifikimit të rreziqeve dhe veprimeve të pasigurta dhe ofron dijen relevante për eliminimin e tyre.



Rufki Suma
Kryetari i komunës së Hanit të Elezit

Si kryetar i komunës së Hanit të Elezit, dua të shprehë kënaqësinë time për Sharrce-min dhe Kompaninë e Titan Group, për vëmendjen e tyre të afërt që ata kanë pasur sa i përket shëndetit dhe sigurisë së punëtorëve të tyre në vendin e punës, e cila besoj që duhet të jetë prioritet për të gjitha kompanitë në vendin tonë, në veçanti ato të klasifikuara si kompani të industrisë së rëndë. Veç zotimit të tyre për siguri në fabrikë, Sharrce-min ka ofruar vëmendje edhe për sigurinë e komunitetit, ku në bashkëpunim me komunën dhe nxënësit e shkollës fillore “Ilaz Thaçi” ata kanë realizuar një projekt të sigurisë me titull “Ngjyrosja e kalimeve të këmbësorëve dhe instalimi i shenjave të trafikut” në Hanin e Elezit, një projekt i cili është mirëpritur nga të gjithë qytetarët. Projektet e tilla veç trajnimeve të ndryshme të ofruara nga Sharrce-min lidhje me shëndetin dhe sigurinë profe-

sionale, si dhe sigurinë e komunitetit janë shumë të nevojshme dhe të justifikuara. Sharrce-min gjithashtu është duke zbatuar sistemin e menaxhimit ISO 18001 dhe pritet të certifikohet kah fundi i këtij viti. Si komunë ne falënderojmë Sharrce-min për kujdesin e tyre të veçantë për Shëndetin dhe Sigurinë.



Rexhep Luri
N.T.P. LURI - kontraktues, Hani i Elezit

Ne shprehim kënaqësinë tonë për bashkëpunimin dhe marrëdhëniet e mira që kemi me Sharrce-min SHPK - kompani e Grupit TITAN që gjendet në Hanin e Elezit, përkatësisht me menaxhmentin e kompanisë. Ky bashkëpunim ekziston tashmë për shumë vite shoqëruar me një shkallë të lartë të mirëkuptimit dhe bashkëpunimit që reflekton një marrëdhënie të shkëlqyeshme ndërmjet palëve. Gjatë kësaj kohe të bashkëpunimit ne kemi pranuar standardet e sigurisë dhe vlerat e aplikuara nga Sharrce-min. Procesi i menaxhimit të kontraktuesve i Sharrce-minit ka ngritur vetëdijen e punëtorëve tanë në lidhje me shëndetin dhe sigurinë e tyre, në këtë mënyrë duke ndërruar qëndrimin dhe sjelljen e tyre që rezultoi në përmirësim të dukshëm të kulturës sonë të sigurisë. Ne dëshirojmë të vazhdojmë këtë nivel bashkëpunimi edhe në të ardhmen gjithashtu.

5.4 Përmirësimi i vazhdueshëm i burimeve njerëzore

Sharrceci si pjesë e Titan Group njih që fuqia punëtore është qendrore për të pasur sukses në operacionet tona, kështu që ne respektojmë të drejtat e punëtorëve, sigurojmë pagat që plotësojnë praktikën e mira të industrisë lokale dhe përpiqemi të ofrojmë më të mirën që është e mundur sa u përket kushteve të punës dhe zhvillimit. Ne vlerësojmë llojllojshmërinë në të gjitha aspektet dhe promovojmë mundësitë e barabarta pa marrë parasysh etnitetin, kombësinë, gjininë, moshën, fenë, aftësitë e kufizuara, orientimin seksual, anëtarësinë në sindikatë, klasën dhe statusin martesor apo familjar.


Aktualisht fuqia jonë punëtore përbëhet nga 502 të punësuar të drejtpërdrejtë

Numri i të punësuarve të rregullt jo të drejtpërdrejtë të cilët janë të angazhuar në shërbime të ndryshme brenda objekteve tona siç janë gurëthyesit, sigurimi, kuzhina, transporti i punëtorëve, mirëmbajtja dhe mbështetja teknike është përafërsisht 75. Ne ofrojmë një llojllojshmëri të kurseve të trajnimit për menaxhment, teknike dhe zhvillim profesional.

Në vitin 2012 kemi ofruar më shumë sesa 3177 orë trajnimi për punëtorët e drejtpërdrejtë dhe më shumë sesa 2124 orë trajnimi për kontraktuesit.

Më tej Sharrceci ka miratuar një program të shpërblyerit për të ndihmuar punëtorët në përmirësimin e mëtejshëm të anës profesionale të tyre me nivel bachelori apo nivel master. Katër punëtorë janë duke përfutur aktualisht nga ky program. Duke e ditur se zhvillimi i aftësive profesionale dhe kompetencave është shumë i nevojshëm dhe i rëndësishëm për punëtorët tanë, janë organizuar trajnime të ndryshme për të gjitha nivelet e punëtorëve me qëllim të zhvillimit të aftësive të punëtorëve dhe

Orët e Trajnimeve të ofruara



udhëheqësve dhe për të ndërtuar një qëndrim që kupton nevojat e industrisë së çimentos dhe nevojat e tregjeve globale. Ne gjithashtu kemi filluar zbatimin e politikave për proceset e përmirësimit të performancës, plane individuale të zhvillimit dhe planifikim të vazhdimin të mëtejshëm, zhvillimin e karrierës dhe zhvillimin e aftësive multi disiplinore dhe kompetencave për fuqinë tonë punëtore. Vlerësimet e performancës dhe trajnimet, transferimi i dijenisë dhe përvojës janë objektivat e përbashkëta në kompaninë tonë.

Benificionet dhe Kompensimi

Ne besojmë në shkëmbimin e sukseseve tona me punëtorët tanë. Ne dëshirojmë të bashkërendojmë synimet e kompanisë dhe të punëtorëve përmes programit tonë të bonusit, gjë e cila bën një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet performancës së kompanisë dhe performancës së individëve dhe pagesës së punëtorit. Ne kup-

tojmë këtë si një ndryshim të rëndësishëm kulturor, mirëpo ende e konsiderojmë këtë si element kyç në arritjen e ekselencës. Benificionet dhe kompensimi i punëtorëve në Sharrcem janë në përputhje të plotë me Ligjin e Punës në Kosovë. Ne sigurojmë pagat që plotësojnë praktikën e mira të industrisë lokale, me një mesatare që është më e lartë sesa ajo e industrisë lokale.



Aktivitetet e burimeve njerëzore

Kontrollet shëndetësore

Duke konsideruar shëndetin e punëtorëve tanë si një çështje shumë të rëndësishme, kemi një objekt për shërbime shëndetësore në kompaninë tonë i cili ofron shërbime bazike shëndetësore për të gjithë punëtorët tanë në baza ditore në fushat e ndihmës së parë dhe konsultime dhe këshilla profesionale në lidhje me mbrojtjen e shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve. Veç kësaj ne organizojmë ekzaminimet e përgjithshme shëndetësore për të gjithë punëtorët në Institutin Mjekësor për Punë në Kastriot, një herë në vit në mars.

Dhurimi i gjakut

Më 13 qershor 2012 kompania jonë ka organizuar dhurimin vullnetar të gjakut me rastin e Ditës Botërore të Dhurimit të Gjakut më 14 qershor, 39 dhurues i janë përgjigjur thirrjes, dhe 30 nga ta kishin dhuruar edhe vitin e kaluar, nga 39 dhurues 31 ishin meshkuj derisa 8 ishin femra. Secili dhurues është shërbyer me një shujtë pa pagesë në kantinën tonë. Po shpresojmë të vazhdojmë me shënimin e kësaj dite me dhurime gjaku në të ardhmen dhe shpresojmë të rekrutojmë sa më shumë dhurues në të ardhmen.


Kantina dhe dollapët + dhomat e pushimit

Në vitin 2012 me qëllim të ofrimit të kushteve dhe hapësira më të mira për punë, Sharrceci ka riparuar tërësisht dhe ka pajisur dy ndërtesa në fabrikë, duke krijuar kështu një kantinë moderne ku dreka ofrohet për punëtorët dhe dollapë me çelës, adekuat dhe higjienik dhe dhoma pushimi për nevojat e tyre ditore.

Benificionet e ofruara për punëtorët me orar të plotë

Kontrolli mjekësor		Po
Sigurimi në punë		Po
Dhurata	Festa fetare	Po
	Dita e gruas	Po
	Viti i ri	Po
Edukim	Master	5
	Kurse të gjuhës angleze	3
	Konferencë	12 Kon./15 menaxherë
Sindikatat	I zakonshëm 50% kontribut	Po
	I jashtëzakonshëm Kontribut direkt	Po
Komunikim	Listat e fakteve	Po
	Billbordet	Po
	Kutitë e sugjerimeve	Po

Punëtorët Anëtarë të Sindikatës (mesatarja 2012)




5.4 Përmirësimi i vazhdueshëm i burimeve njerëzore | Vazhdim

Ngritja e vetëdijes së brendshme

Një mënyrë për të hapur komunikimin me qëllim të themelimit të vlerave të CSR si një kulturë jetese tek të gjithë punëtorët tanë.

Pyetësi i CSR dërguar të gjithë punëtorëve për përgjigje po ose jo



Me këtë kemi filluar të komunikojmë kuptimin e CSR dhe arsyetimin. Do të zhvillohet si "çështje diskutimi" tremujore dhe do të nisë pjesëmarrjen e punëtorëve përmes përdorimit të "kutive të sugjerimeve".

6. Komuniteti lokal

Karakteristikat e komunës së Hanit të Elezit

Hani i Elezit gjendet në pjesën juglindore të Kosovës në afërsi të kufirit me IRJ të Maqedonisë. Gjendet në luginën ndërmjet maleve të Sharrit në perëndim dhe maleve të Karadakut (malet Rodope -1218m) në lindje. Komuna ka dhjetë fshatra dhe qytezën e Hanit të Elezit.


Në tregjet në zhvillim, dhe më shumë në ato që kanë dalë nga situatat e luftës, siç është rasti me Kosovën, është i rëndësishë kapitale të kuptohet vështirësia aktuale dhe problemet me të cilat përballlet shoqëria.

Sharrçemi me kujdes ka analizuar situatën në vend dhe në veçanti në komunën e Hanit të Elezit duke përdorur të gjitha burimet e informatave. Në faqet në vijim veprimet e vitit 2012 janë nënvizuar; kompania ka përgatitur në vitin 2012 një qasje të plotë të veprimeve strategjike për vitin 2013 për adresimin e problemeve lokale dhe ndjeshmërisë.




Popullata

Sipas të dhënave nga hulumtimet në terren popullata vlerësohet të jetë rreth 10,065 banorë, të cilët në numër dominues janë shqiptarë etnik.



Papunësia




Shkalla e Varfërisë



Migrimi

POPULLATA ME VENDBANIME DHE VITI I REGJISTRIMIT



Source: Municipal Mid-Term Plan

6.1 BKLP (Bordi Këshillëdhënës Lokal i Pavarur)

Me synim të fuqizimit të transparencës dhe përfshirjes së drejtpërdrejt të hisedarëve kryesor, menaxhmenti i Sharrcemit ka vazhduar me themelimin e një Bordi Këshillëdhënës të Komunitetit Lokal. Ky bord është dizajnuar të shërbejë si ndërlidhje ndërmjet komunitetit dhe Sharrcemit me qëllim të kanalizimit të drejtë të aktiviteteve mbështetëse të kompanisë drejt shoqërisë lokale. Bordi është i përbërë nga hisedarë të ndryshëm të komunitetit si dhe dy punëtorë të Sharrcemit nga niveli i mesëm i menaxhmentit dhe banorët e Hanit të Elezit, dhe është përgjegjës për kuptimin e nevojave dhe propozimeve të parashtruara nga hisedarët lokal për mbështetje financiare nga kompania, si dhe shpërndarje të fondeve të Sharrcemit të dedikuara për zhvillim të komunitetit. Kjo ka rezultuar në shumë iniciativa të ndryshme lokale që kanë përmirësuar situatën si për komunitetin ashtu edhe për kompaninë.

Ky partneritet është krijuar për të përmirësuar komunikimin dhe bashkëpunimin ndërmjet Sharrcemit dhe komunitetit ku operon. Objektivat primare kanë qenë për krijimin e iniciativës bashkëpunuese dhe transparente që do të themelonte partneritet ndërmjet kompanisë dhe hisedarëve ashtu që fondet e zhvillimit të komunitetit do të alokoheshin dhe investoheshin më mirë. Sipas traditës shumë kërkesa për ndihmë dhe mbështetje janë adresuar tek kompania të cilat tenderonin asistencën në baza më arbitrare për dhjetë vitet e kaluara. Ideja ka qenë që përmes këtij partneriteti të krijohet një ndikim pozitiv për të gjithë, duke përfshirë komunitetin lokal dhe duke u dhënë atyre përgjegjësinë për një përgjigje të drejtë për nevojat lokale, derisa në të njëjtën kohë duke fuqizuar lidhjet ndërmjet komunitetit dhe kompanisë. Fushëveprimi i BKLP-së

është të zbulojë dhe caktojë prioritetet për nevojat e komunitetit dhe për të alokuar në mënyrën e duhur, në vendime unanime, fondet e ndara nga Sharrcemi për përmirësimin e standardeve të jetës së komunitetit në tri drejtime kryesore: siguri, mjedis dhe arsim. Mbi të gjitha BKLP lejohej të alokojë fonde për bamirësi në ato raste kur vlerësohet si e nevojshme. BKLP operon që nga viti 2011 dhe ka zhvilluar aftësinë për të vendosur në mënyrë unanime dhe me shkallë të lartë të përfshirjes dhe bashkëpunimit. BKLP takohet në objektet



komunale dhe gëzon një reputacion të shkëlqyeshëm dhe mbështetje nga autoriteti dhe qytetarët poashtu. Një numër projektesh janë propozuar dhe ndërmarrë përmes procesit të BKLP-së në parim, në mjedis, infrastrukturë dhe në siguri. Në anën e arsimit Sharrcemi gjithashtu ka lansuar një iniciativë të dalluar me shkollën e arsimit fillor në Hanin e Elezit. Duhet të theksohet se në bazë sipas rastit, Sharrcemi gjithashtu edhe drejtpërdrejt shton fonde plotësuese për ato projekte të BKLP-së që vlerësohet të jenë të rëndësishme së veçantë mjedisore apo të sigurisë, dhe përputhen me prioritetet e kompanisë. Një dialog i hapur dhe i vazhdueshëm është zhvilluar menjëherë pas disa takimeve të Bordit. Këto shkëmbime të pikëpamjeve dhe informacioneve në fakt janë zgjeruar deri në nivele më të ulëta organizimi si në



komunë ashtu edhe në kompani. Përmes një komunikimi të tillë, autoritetet lokale dhe qytetarët për herë të parë kanë kuptuar më mirë mënyrën se si funksionon fabrika dhe kanë diskutuar prioritetet e komunitetit. Si rrjedhojë punëtorët e Sharrcemit dhe menaxhmenti gjithashtu kanë pasur mundësinë të marrin një pamje të qartë për kufizimet me të cilat përballet shoqëria lokale, kështu duke konfirmuar dhe përshtatur strategjinë e CSR. Në fakt strategjia e re afatgjatë e kompanisë është e bazuar në analiza të të dhënave dhe informacionet kthyesë të punës së bordit. Bordi, në bazë të një metode të votimit unanimitet shpërndanë fonde për projektet dhe veprimet në dobi të komunitetit lokal. Të gjitha vendimet e BKLP-së dokumentohen dhe mbahen në dosjet e komunës dhe të kompanisë. Anëtarët e emëruar në këtë bord nga grupet relevante të hisedarëve përfshijnë: Kryesuesin e Asamblesë Komunale, Drejtorin Komunal për Zhvillim Ekonomik, Drejtorin Komunal për Urbanizëm dhe Kadastër, Drejtorin e QKMF-së, një Imam (nga komuniteti fetar), një punëtor nga sektori i arsimit, një qytetar privat (person biznesi) dhe 2 përfaqësues të Sharrcemit. Dëshirojmë të falënderojmë komunën e Hanit të Elezit për mbështetjen dhe kontributin e tyre për suksesin e BKLP-së.

Për vitin 2012, fondi i BKLP-së ka qenë 33.550 € nga totali prej 156.955 € në kontribute sociale.

6.2 Aktivitetet e Komunitetit

“Sharri i Gjelbër” Një ditë e hapur e fabrikës për komunitetin

Shënimi i zbatimit të programit të modernizimit të fabrikës dhe kryesisht investimet për mbrojtjen e mjedisit në qershor 2012, Sharri ynë i Gjelbër / Dita e Hapur është mbajtur dhe aty morën pjesë më shumë se 5,000 pjesëmarrës, të etur për të dëgjuar lajmet më të reja dhe zhvillimet që kanë të bëjnë me Sharrcemin. Më tej vizitat me shoqërim nëpër fabrikë ofroheshin për të gjitha grupet e interesuara për të vizituar vend prodhimit dhe për të mësuar më shumë në lidhje me proceset.

Këto vizita shërbyen për të edukuar vizitorët në lidhje me investimet e konsiderueshme që janë bërë nga Sharrcemi me synim të përmirësimit të mjedisit dhe procesit të prodhimit.



Kryetari i Hani i Elezit e falënderoi Sharrcemin dhe Grupin Titan për angazhimin e tyre drejt mbrojtjes së mjedisit dhe lavdëroi punën e tyre të kryer duke iu referuar ajrit dukshëm më të pastër brena dhe rreth fabrikës. Kjo u shoqërua me organizimin e një programi kulturor dhe artistik për të gjitha moshat ku vlen të theksohet një moment i veçantë ku fëmijët e vegjël nga komuniteti lokal ishin veshur me uniformat e fabrikës së Sharrcemit dhe kanë recituar një vjershë dedikuar Sharrcemit, që ishte shkruar nga një mësues banor i këtij vendi. Kjo vjershë është përkthyer dhe miratuar me krenari nga Sharrcemi dhe është përfshirë në këtë raport, së bashku me versionin original në gjuhën shqipe (në faqen tjetër). Pjesëmarrësit pastaj janë gostitur në një takim dhe u është ofruar një koktej dhe shujtë rasti.



Fabrika jonë

Bam, bam, bam, bam, bam, bam
Kjo fabrika bën gdo gast

Ne jemi të vegjël po dimë diçka
Qyteti ynë shumë nam ka

Oxhaku i gjatë tregon diçka
Kjo fabrika jonë më pluhur nuk ka

E bukur krenare në mes të qytetit
Kjo fabrika jonë ja rrit vlerat vendit

Të thithim ajër të thithim oksigjen
Mushkërit tona asgjë mos ti qenë

Një falenderim për ju që menduat
E haqët pluhurin për ne investuat

Të dashur qytetarë ne thirrje ju bëjmë
Qytetin tonë të pasatër ta mbajmë

Një falenderim dhe për ju komunar
Na zbukuruat qytetin e bëtë të paparë

Gershor 2012, Lindita Kaloshi

Our Factory

Bam-bam, bam-bam, bam-bam
This factory of ours hums every day

We are young but know full stride
Our dear town has lots of pride

The long chimney shows something just
This factory of ours no longer has dust

Beautiful and proud in the middle of town
This factory of ours is our town's crown

Great, big thanks to you who thought of us
Taking care of the people and removing all the dust

Dear and honorable citizens we have one request
That our town to be kept clean is best

A big thanks to our municipal leaders
For making our town the most beautiful and cleanest

Composed by: Lindita Kaloshi - Teacher


Ndriçimi i rrugëve në Han të Elezit

Situatat në magjistralen kryesore që shpien në linjën kufitare të Hanit të Elezit ishte e papërshtatshme dhe plotësisht e pasigurt gjatë orëve të mbrëmjes, ku një gjatësi e rrugës prej 1,150 metrave nuk ishte fare e ndriçuar.

Një projekt propozim është bërë për instalimin e ndriçimit, i cili u miratua nga menaxhmenti i Sharrcemit në fund të vitit 2011. Bazuar në të dhënat e mbledhura lidhur me magjistralen (veturat, kamionët, këmbësorët) klasa e propozuar për ndriçim publik ishte B1.

- Këmbësorët, 150-600/h
- Veturat dhe kamionët, 1000-3000/24h
- Shpejtësia e vozitjes, 40km/h

Rryma elektrike për projektin është duke u furnizuar nga transformuesi prej mag-



jistrales i cili funksionon përmes një kutie të ngritur për shpërndarjen e energjisë elektrike.

Standardet më të larta janë zbatuar gjatë shtrirjes së kablos elektrike dhe vendosjes dhe ngritjes së shtyllave elektrike.

... pak më mirë ... pak më sigurt ...

Infrastruktura publike e Kosovës në përgjithësi vuan nga mungesa e kushteve të sigurisë për qytetarët, në mbarë vendin. Me projektet e veta “... pak më mirë ... pak më sigurt ...”, Sharrcemi planifikon të përmirësojë sigurinë dhe funksionalitetin në zonat e përzgjedhura në nevojë, përmes përmirësimeve të vogla urbane në mbarë Kosovën.

Shkolla fillore “Emin Duraku” - Kaçanik

Sharrcemi vazhdoi duke e dëshmuar përkushtimin e tij në përmirësimet e infrastrukturës në zonat urbane të komuniteteve fqinje. Në gusht të vitit 2012 ai ka ndërmarrë përpjekjen për të përmbyshur renovimin e oborrit të shkollës fillore të “Emin Duraku” në Kaçanik, që ishte vjetruar dhe krijonte rrezik. Si prodhues i çimentos, Sharrcemi ka ndërmarrë dhe i ka mbuluar financiarisht punimet ndërtimore, një fushë ku ai ka përvojën më të mirë dhe mund të kontribuonte më së miri. Për më shumë se tri javë, gjashtë punëtorë të Sharrcemit i kanë bërë ballë nxehtësisë përvëluese të gushtit duke nxituar të përgatisin oborrin e shkollës para fillimit të vitit shkollor.



Urbanizimi (drunjtë dhe shenjat)-gurëthyesit dhe brenda fabrikës

Hapi i parë i planit të rehabilitimit sipas studimit EIA për Gurëthyesin e Dimçes me 46,185 ton djerrinë, mbjellja e zonës së gjelbër prej 227 fidane drunjsh dhe krijimi i 700 metrave të brezit të gjelbër ka filluar në vitin 2012.

Hapësira e gjelbër rritet dhe mbjellja e drunjve të rinj brenda zonës së fabrikës bëhet çdo vit.

6.2 Aktivitetet e Komunitetit | Vazhdim

Pas shtrirjes së më shumë se 400 metrave katror të gurëve të betonit, 120 metra mure, një skenë për të hendikepuarit, një lavaman me 5 rubineta uji, me një vlerë totale prej më shumë se 8,000 Euro, të rinjtë e shkollës fillore do të jenë në gjendje të gëzojnë një mjedis shumë më të mirë dhe të sigurt.

Një praktikë e shkëlqyer e CSR është pasi që përfshinë fuqinë punëtore dhe materialet e ofruara nga Sharrceci dhe kontraktues tjerë lokal pa pagesë.

Lumi Dimçe

Komuna e Hanit të Elezit kishte nisur një projekt për rregullimin e brixhëve dhe shtratit të Lumit Dimçe në Hanin e Elezit duke siguruar bashkë financimin nga Fondi i Zhvillimit të Komunitetit ("FZHK"),



përmes një granti që FZHK kishte fituar përmes Bankës Botërore si pjesë e "SILED". FZHK dhe komuna kishte lidhur një memorandum të mirëkuptimit për bashkë financim dhe zbatim të projektit dhe të zhvilluar bashkërisht propozimin e projektit i cili ishte miratuar nga organet kompetente të Komunës, në përputhje me Ligjin në fuqi. Buxheti i projektit me-

jithatë ka tejkaluar fondet komunale dhe të FZHK-së dhe Sharrceci është ftuar të asistojë për zbatimin e projektit. Gjë që bije pikërisht në thelb të strategjisë së CSR për të mbështetur projektet të cilat kanë synim përmirësimin dhe mbrojtjen e mjedisit të komunitetit lokal, kompania është pajtuar të mbulojë 27,000 eurot e mbetura për zbatimin e projektit në bashkëpunim me FZHK-në dhe komunën.



Një memorandum i mirëkuptimit që shpilen tek një marrëveshje e re e partneritetit ndërmjet Sharrceci dhe komunës së Hanit të Elezit është arritur në vitin 2012 dhe ka hapur derën për ndërtim.

Konferenca "SHARRCEMI I RI"

Sharrceci me krenari ka shpallur fazën finale të programit të tij për përmirësimin e qëndrueshmërisë mjedisore, ndikimin nga emetimet dhe avancimin e efikasitetit të tij që nevojitet për zgjerimin e tregut të ndërtimit në Kosovë.

Me dëshirën për ndarjen e dobive të këtyre investimeve me të gjithë hisedarët, Sharrceci organizoi konferencën e "Sharrceci të ri", një angazhim i rëndësishëm për të takuar më shumë se 150 klientë dhe furnitorë që ishin të pranishëm së bashku me autoritetet publike dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile. Kompania pati rastin të paraqesë rezultatet e arritura dhe planet e saj për të ardhmen dhe të përgjigjet në pyetje të pjesëmarrësve.




Sharrceci - pjesë e fushatës "LE TA BËJMË KOSOVË"

Në maj 2012 Sharrceci mori pjesë në fushatën "Le ta Bëjmë Kosovë, 2012". Synimi i kësaj fushate ka qenë mobilizimi i qytetarëve të Kosovës për të mbrojtur dhe mbajtur mjedisin të pastër. Sharrceci ka marrë pjesë në mënyrë aktive

në këtë organizim brenda komunës së Hanit të Elezit dhe ka mbështetur këtë aksion të komunës me 150 pako të dorezave plastike dhe 500 maska mbrojtëse. Si një pjesëmarrës aktiv, Sharrceci ka qenë i përfshirë në aktivitetet e pastrimit si dhe me 35 punëtorë me sukses i kanë kontribuar kësaj ngjarjeje.



6.2 Aktivitetet e Komunitetit | Vazhdim




Ndërtimi i rrugëve / përmirësimi i anësoreve

Në afërsi të portës jugore II të fabrikës, një rrugë komunale ka qenë nën rindërtim në tremujorin e II-të vitit 2012. Intervenimet e ndërtimit në një pjerrësi laterale që lidhet me kufirin e fabrikës janë kryer pa llogaritje

dhe masa të stabilitetit të pjerrësisë. Gjithashtu punët intervenuese kishin dëmtuar një shtyllë të energjisë elektrike të tensionit të lartë duke krijuar kështu një situatë shumë të pasigurt (ku kablo e energjisë elektrike ka qenë e pambrojtur dhe e siguar në mënyrë jo të mjaftueshme).

Sharrcem ka intervenuar me dizajnimin e murit të duhur mbajtës për të rivendosur stabilitetin e pjerrësisë dhe duke financuar dhe ndërtuar rrethojat e duhura dhe themelet e reja për bartjen e shtyllës së dëmtuar të kabllos, duke e rritur kështu sigurinë e të gjithë të prekurve.

Ndarja e kontributit social në vitin 2012



- Infrastruktura
- Kultura / sporti dhe feja
- Ndihma individuale solide
- Arsimi
- Benificionet shtesë për punëtorët dhe sindikatat

7. Mjedis



Ndryshimi i mjedisit dhe klimës

Procesi i prodhimit të çimentos ndikon në mjedis. Operacionet e Sharrcemit varen shumë nga përdorimi i burimeve natyrore. Jemi të vetëdijshëm për ndikimin tonë në natyrë dhe kjo është arsyeja pse kujdesi ndaj mjedisit është një nga prioritetet tona të para në të gjitha aspektet e sjelljes sonë. Pluhuri, zhurma, rrezikimi i sigurisë, ndryshimi i pamjes nga përdorimi i lëndëve të para, emetimet në ajër, konsumimi i energjisë dhe ujit janë çështje që lidhen me performancën e përditshme. Për këtë arsye, ne marrim përsipër veprime që reduktojnë ndikimin tonë operacional mbi mjedisin. Monitorimi, vlerësimi, raportimi, bashkëpunimi, veprimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm është mënyra se si ne i adresojmë çështjet e mjedisit. Përmes qasjeve tona të CSR, ne synojmë adresimin e këtyre çështjeve kryesore të mjedisit:

- *Ndryshimi i klimës*
- *Energjia dhe lëndët e para*
- *Ajri dhe emetimet tjera*
- *Biodiversiteti*
- *Uji*

Sharrcemi u përmbahet të gjitha rregullorëve vendore dhe kombëtare për mbrojtjen e mjedisit.

ISO 14001

Sharrcemi në vazhdimësi përpiqet t'i adresojë sfidat e definuara të mjedisit. Në këtë fushë, jemi duke i zbatuar tërësisht politikat e TITAN-it të cilat garantojnë menaxhim të sigurt dhe transparent sipas praktikave më të mira ndërkombëtare. Përveç kësaj, në qershor të vitit 2012, kemi filluar me themelimin dhe zhvillimin e standardit për menaxhimin e mjedisit ISO 14001 i cili do të zbatohet dhe certifikohet deri në fund të vitit 2013.

KIMN (IPPC)

Me 14 shtator Sharrcemi ka parashtruar një aplikacion për lejen e Kontrollit të Integruar për Parandalimin e Ndotjes (KIPM) në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Aplikacioni, përveç planifikimit të ndikimit në mjedis për operacione të rregullta mbulon edhe parakushtet e bashkë-pro-

cesimit të KA (karburantet alternative) të cilat sot përbëjnë një pjesë integruese të standardeve industriale të çimentos pasi që ofrojnë një zgjidhje fito-fito si nga reduktimi i ndikimit të emetimeve ashtu edhe vëllimit të mbeturinave të hedhura. Përpjekja drejt operacioneve të padëmshme për mjedisin është pjesë e vlerave të përbashkëta të Grupit TITAN dhe në të njëjtën kohë një obligim që ngritët nga legjislacioni vendor dhe i BE-së për një mjedis të qëndrueshëm. Sharrcem do të ketë një qasje formale dhe transparente për një menaxhim të integruar operacional të ndikimit në mjedis së bashku me një plan të rishikuar në baza vjetore të përmirësimit të vazhdueshëm. Për këtë qëllim, kompania tashmë ka vendosur bashkëpunim të afërt dhe të rregullt me MMPH.

Sistemi i menaxhimit të CO2

Kompania, sipas politikave të Grupit ka zbatuar një sistem të plotë vlerësimi dhe menaxhimi të CO2 i cili auditohet në baza vjetore nga një auditor i pavarur dhe i certifikuar i palës së tretë (për 2012 KPMG).

Investimet

Prodhimi i çimentos është një industri kapital intensive. Në të njëjtën kohë është edhe një proces intensiv i karburanteve. Përdorimi i lëndëve të para dhe energjisë për prodhimin e çimentos ndikon në mjedisin që rrethon, prandaj një nga prioritet kyçe është përmirësimi i vazhdueshëm i teknologjisë dhe sistemeve të menaxhimit në mënyrë që të zvogëlohet ndikimi potencial mbi njerëzit dhe mjedisin. Besnik ndaj vlerave të tij të përbashkëta, vizioni i Titanit për Sharrcemit është “të njihet si pikë referimi në Kosovë përmes shkëlqimit operacional, respektit për mjedisin dhe kontributit të konsiderueshëm për shoqërinë”. Në përputhje me këtë vizion, menjëherë pas marrjes së Sharrcemit, Titan filloi një program modernizimi duke theksuar përmirësimin e sigurisë, performancën e mjedisit, produktivitetin dhe be-

sueshmërinë, përderisa siguron që cilësia e çimentos të jetë në nivelin më të lartë. Më 20 qershor 2012, fabrika e Sharrcemit në Kosovë, ka inauguruar pajisjet e reja “të fjalës së fundit” për mbrojtjen e mjedisit. Janë instaluar dy filtra të ri me thasë, për furrën dhe ftohësin e madh, dhe sistemi i vlerësimit të emisionit të vazhdueshëm (SVEV). Përveç këtyre investimeve prioritare, kompania ka investuar gjithashtu në një ndarëse të re të gjeneratës së tretë me filtrin tonë të shpluhurosjes për mullirin e çimentos # 3, një laborator të ri përfshirë spektrometrin XRF dhe automatizmin QCX dhe një DHQK (dhomë qendrore e kontrollit) plotësisht të re. Për sigurimin e performancës së qëndrueshme, kompania ka komisionar të gjithë makinerinë e prodhuesve int'l me historik të dëshmuar dhe reputacion nga Gjermania, Austria, Italia, Danimarka dhe Holanda.



Mbrojtja e mjedisit		€	
1	Filtri i furrës kryesore	2.600.000	Mar. 12
2	Filtri i ftohësit	2.100.000	Mar. 12
3	Sistemi i matjes së vazhdueshme	350.000	Shku. 12
TOTAL		5,050.000	

Përmirësimi i efijencës		€	
4	CM#2 Separatori	1.800.000	Mar. 12
5	Stacioni i paketimit #2	680.000	
6	Analizuesi Spektro Laborator	710.000	Jan. 12
TOTAL		3,190.000	

Qysh në fillim, kompania ka investuar në çmontimin dhe largimin e katër rezervuarëve të mëdha, të vjetra dhe të rënda të naftës dhe ka instaluar një rezervuar të ri të vogël të fjalës së fundit. Në këtë mënyrë, rreziku nga rrjedhjet ose derdhjet është eliminuar plotësisht (zero incidente gjatë vitit 2012).

7.1 Performanca e mjedisit

Monitorimi i emetimeve është një parakusht për kontrollimin dhe reduktimin e ndikimeve ndaj mjedisit nga prodhimi i çimentos. Në vitin 2012, fabrika e Sharrcemit ishte kompania e parë në vend që ka futur sistemet e pavarura me monitorim të vazhdueshëm, që operojnë 24 orë në ditë. Kjo i mundëson kompanisë që të monitorojë nga afër emisionet në baza kohore reale dhe të ndërmarrë veprime në përputhje me

rrethanat. Në të njëjtën kohë, ai u ofron hisedarëve të interesuar informata të rregullta dhe të përditësuara mbi performancën e tij. Sharrcemi aktualisht operon një sistem automatik 24 orësh me monitorim të vazhdueshëm (instaluar në mars të vitit 2012) të kalibruar dhe certifikuar nga një palë e pavarur sipas standardeve evropiane. Një përmbledhje e llojeve të instrumenteve, pi-

kat e instalimit dhe parametrat që vlerësohen janë paraqitur në tabelën në faqen 38. Të dhënat që rrjedhin nga vlerat e vlerësuara procesohen duke përdorur softuerë të licencuar MEAC 2000. Vlerat e procesuara janë paraqitur në pajtueshmëri me kërkesat ligjore dhe dërgohen rregullisht në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (“MMPH”).

Matja e ndikimit të CO₂

Ndryshimi i klimës konsiderohet si sfida më e madhe mjedisore e kohës sonë. Natyra e industrisë së çimentos është e tillë që prodhon dhe emeton dyoksid karboni (CO₂), kështu që i kontribuon efektit serë dhe ndryshimit të klimës. Emetimet e drejtpërdrejta të CO₂ nga prodhimi i vet çimentos i atribuohen:

- De-karbonizimit, procesit të transformimit të lëndëve të para (kryesisht argjilë) në klinker, komponenti kryesor i çimentos.
- Konsumimit të karburantit, përfshirë karburantet që digjen në furra (mazut dhe pet kok) dhe karburante që përdoren për transportim të brendshëm prodhojnë CO₂ si rezultat i reaksionit kimik ndërmjet karbonit (C) dhe oksigjenit (O₂). Emetimet indirekte të dyoksidit të karbonit lirohen nga energjia elektrike që nevojitet për prodhimin e klikearit dhe çimentos, si dhe gjatë transportimit të jashtëm të lëndëve të para, karburantit dhe produkteve finale. Si pjesë e Titan Group ne ndjekim standardet WBCSD/CSI për llogaritjen dhe raportimin e emetimeve të CO₂.

Emetimet në ajër / pluhuri

Në fabrikat e çimentos, burimet kryesore të emetimit të pluhurit janë tymtarët e furrës dhe sipërfaqet e hapura që krijojnë pluhur i

cili del jashtë nga transportimi i materialeve. Nga viti 2012 Sharrcem është pajisur me sistem të monitorimit të vazhdueshëm automatik 24 orë që matë dhe regjistron emetimet e veta në bazë të kohës së vërtetë. Pas rindërtimit të ri të filtrave me thasë në furrë dhe mullirin e materialit, emetimet e pluhurit janë reduktuar shumë nën limitet (ELV) që është vënë nga kushtet mjedisore dhe kushtet e kërkesave ligjore vendore dhe të BE-së. Grafiku në faqen tjetër paraqet efektin e menjëhershëm të investimit të lartpërmendur.

SOx

Prania e sulfurit (S) në lëndën e parë është shkaku kryesor i emetimeve SOx. Emetimet SOx të Sharrcemit janë shumë nën limitet (EV) caktuar nga kushtet mjedisore dhe kushtet e kërkesave ligjore vendore dhe të BE-së.

NOx

Djegia në temperaturë të lartë shpien tek emetimet NOx. Studimet shkencore kanë treguar se emetimet NOx mund t'i kontribuojnë shiut acidik dhe smogut. Në vitin 2012 emetimet e tërësishme të NOx në Sharrcem kanë qenë shumë nën limitet (EV) caktuar nga kushtet mjedisore dhe kushtet

e kërkesave ligjore vendore dhe të BE-së, me një trend të vazhdueshëm përmirësimi.


Uji

Sharrcem operon me një sistem tërësisht të mbyllur të ujit. Uji është për nevoja të përpunimit, ftohjen e pajisjeve, për nevoja mjedisore dhe për nevoja sanitare. Burimet kryesore të furnizimit të ujit për fabrikën e Sharrcemit janë ujërat nëntokësore nga pusët e hapura brenda zonës së fabrikës. Nuk ekziston vend-shkarkim për ujë të mbetjes industriale, vetëm uji sanitar shkakohet në dy dalje të ujit në fabrikë. Konsumi i përgjithshëm i ujit nga prodhimi i çimentos është shumë efikas - 320 l ujë / t çimento. Një studim i plotë hidro-gjeologjik është përgatitur nga ekspertët e jashtëm për të siguruar vlerësimin për kushtet hidro-gjeologjike të Sharrcemit dhe zonave përreth për të:
- siguruar përdorim të qëndrueshëm të ujit nëntokësor që nxirret nga pusët brenda fabrikës
- të vlerësohet ndikimi i ujëmbajtësve - hartat dhe vizatimet
- të verifikohet zero efekti nga operimi ynë
- studimi është bërë në vitin 2012 me një hulumtim prej 18 muajsh të plotë dhe rezultatat do të prezantohen në raportin e vitit 2013.


Continuing Measurements Environment

#	Pajisjet	Nëntipi	Parametrat e matur	Data e instalimit	Lokacioni
1	Sick düsthunger	Monitorues i koncentrimit të pluhurit	Pluhur	Prill 2012	Furra & mulliri
2	Sick GM 32	Analizues gazi në vend	SO ₂ , NOx, T, P	Prill 2012	Furra & mulliri
3	Sick GM 35	Analizues gazi për CO, CO ₂ , H ₂ O	CO, CO ₂ , H ₂ O, T, P	Prill 2012	Furra & mulliri
4	Sick Flowsic100 H	Monitorues i shpejtësisë së gazit	Shpejtësia e gazit, Shpejtësia e zërit,	Prill 2012	Furra & mulliri
5	Sick ZIRKOR302 P	Analizues Oksigjeni	O ₂	Prill 2012	Furra & mulliri
6	Sick DUSTHUNTER SP100	Monitorues i koncentri. Pluhurit	Pluhur	Janar 2013	Oxhaku i zgjyrës
7	Sick Flowsic100/200	Monitorues i shpejtësisë së gazit	Shpejtësia	Janar 2013	Oxhaku i zgjyrës


Emetimet Bruto Specifike CO₂



Emetimet bruto specifike CO₂




Emetimi SO_x




Koncentrimi mesatar i SO_x për furrën ishte 14 mg/Nm³, derisa ELV është 400 mg/Nm³

Emetimi NO_x




Koncentrimi mesatar i NO_x për furrën ishte 366 mg/Nm³, derisa ELV është 800 mg/Nm³.

Emetimi i pluhurit




Përqendrimi mesatar i pluhurit për furrën ka qenë 12 mg/Nm³. ELV është 50 mg/Nm³. Investimi i realizuar në vitin 2012 paraqet përmirësimin e menjëhershëm të arritur

Konsumi i nxehtësisë specifike Zhvillimi (YOY, viti referent 2009)



Avancimet e efijencës kanë nisur në vitin 2011 dhe janë kryer në vitin 2012, kanë rezultuar me përmirësime të rëndësishme të konsumit të nxehtësisë.

Konsumi i energjisë termike



Konsumi i energjisë termike
687,732 GJ.

Konsumi i energjisë
42,881 MWh.

7.2 Ngritja e vetëdijes për mjedisin

Vizita nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Në qershor 2012, Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, z. Dardan Gashi ka vizituar fabrikën e Sharrcemit, ku ka marrë informata të dorës së parë lidhur me investimet për mbrojtjen e mjedisit. Vizita është ndjekur nga afër nga media.



“SHARRI I GJELBËR” CEREMONIA e inaugurimit

Ceremonia e inaugurimit për pajisjet e reja të fjalës së fundit për mbrojtjen e mjedisit, u mbajt në mëngjesin e 20 qershorit 2012 në Sharrcem. Në këtë ngjarje morën pjesë një numër i madh i zyrtarëve shtetëror dhe vendor, ambasadorë të huaj si dhe përfaqësues të komunitetit të biznesit të Kosovës. Ngjarja u hap me fjalime nga kryetari i Hani i Elezit, z. Refki Suma, zëvendës ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, z. Shpëtim Rudi dhe përfaqësuesi e nivelit të lartë të Sharrcemit dhe Grupit të Titanit. Pastaj ajo vazhdoi me ceremoninë e prerjes së shiritit që u bë nga personat e lartpërmendur për festimin e aktivizimit të pajisjeve të instaluar për mbrojtjen e mjedisit. Kryetari i Hani i Elezit e falënderoi Sharrcemin dhe Grupin e Titanit për angazhimet e tyre drejt



mbrojtjes së mjedisit dhe lavdëroi punën e bërë duke iu referuar ajrit që është dukshëm më i pastër brenda dhe rreth fabrikës.

Partneriteti me shkollën

Duke ndjekur politikën e tij sociale të mbështetjes për zhvillimin përmes edukimit, bazuar në partneritetin e fuqishëm vendor, raportet e mira fqinjësore, dhe nevojat për komunitetin vendor, menaxhmenti i Sharrcemit ka miratuar një kërkesë nga shkolla e mesme “Dardania” Hani i Elezit për ta vizituar fabrikën e Sharrcemit me qëllim të informimit më të mirë rreth investimeve të reja dhe përmirësimit të mbrojtjes së mjedisit. Vizita e fabrikës u organizua në maj të vitit 2012 dhe Sharrcemi siguroi që, për shkak të sigurisë së nxënësve, vizita në fabrikë të organizohej me autobus nën mbikëqyrjen e menaxherëve përgjegjës. Në fund të vizitës së fabrikës dhe prezantimit nga menaxheri i mjedisit, të gjithë nxënësit dhe profesorët e tyre u shërbyen me drekë në kantinën e Sharrcemit.



Nusret Shiti Administrator i Hani i Elezit

Duke pasur parasysh qytetin tonë të vogël, që në qendër të tij ka një prodhues të madh të çimentos, në të kaluarën përveç që shërbente si privilegj gjithashu ishte edhe një problem pasi që pluhuri që emetohej nga ai mbulonte të tërë qytetin deri në atë masë sa që nuk mund të gjendej askund asnjë kulm i kuq. Tash kjo situatë ka ndryshuar për 99%. Pasi që fabrika gjigante u bë pronë e Grupit të Titanit, dhe si rezultat i kujdesit të tyre për mbrojtjen e mjedisit, u instaluan filtra që parandalojnë ndotjen nga pluhuri. Dëshirojmë t'ua shprehim mirënjohjen tonë pronarëve të rinj që këtë e kanë marrë në konsideratë.

8. Tabela e shpjegimit të GRI

EC - Performanca ekonomike			
#	Treguesi	Definicioni	Faqe në raport
1	EC1	Vlera ekonomike direkte gjeneruar dhe shpërndarë	7
2	EC5 *add	Proporcioni i pagës minimale në kompani dhe paga minimale në Kosovë	19
3	EC6	Politika, praktikat e biznesit dhe përqindja e furnitorëve lokal në total për kompaninë	14
4	EC7	Procedurat për punësim lokal dhe përqindja e menaxhmentit të lartë nga komuniteti lokal	19
5	EC8	Investimi në komunitetin lokal	7,35

EN - Mjedisi			
#	Treguesi	Definicioni	Faqe në raport
6	EN1	Materialet e përdorura nga pesha dhe vëllimi	7
8	EN3	Konsumi direkt i energjisë nga burimi primar	39
9	EN8	Konsumi i përgjithshëm i ujit nga burimi	38
10	EN16	Emetimi i përgjithshëm direkt dhe indirekt i gazrave me efekt serë	39
11	EN20	NOX, SOX dhe emetimeve tjera të mëdha	39
12	EN21	Ujërat e zeza	38
14	EN23	Numri i përgjithshëm dhe vëllimi i rrjedhjeve me rëndësi	37
15	EN28	Vlera monetare e gjobave të mëdha dhe numri i përgjithshëm i sanksioneve për Mos përputhje me ligjet dhe rregulloret mjedisore	36

LA - Puna			
#	Treguesi	Definicioni	Faqe në raport
16	LA1	Fuqia e përgjithshme punëtore	19
17	LA2	Numri i përgjithshëm dhe shkalla e qarkullimit të punëtorëve	19
18	LA3	Benificionet e ofruara për punëtorët me orar të plotë	27, 35
19	LA6 *add	Punëtorët e angazhuar në borde të përbashkëta dhe shëndet e siguri profesionale	25
20	LA7	Lëndimet në punë	20
21	LA10	Orët e trajnimit	21, 26
23	LA13	Struktura e fuqisë punëtore	19, 27

HR - Të drejtat e njeriut			
#	Treguesi	Definicioni	Faqe në raport
25	HR4	Numri i përgjithshëm i incidenteve të diskriminimit dhe aktivitetet korrigjuese	19

SO – Shoqëria			
#	Treguesi	Definicioni	Faqe në raport
26	SO1	Programet e aplikuara për përfshirje të komunitetit lokal, vlerësimi i ndikimit dhe Zhvillimi i programeve	30, 35

8. Tabela e shpjegimit të GRI | Vazhdim

PR - Përgjegjësia e produktit			
#	Treguesi	Definicioni	Faqe në raport
29	PR2 *add	Numri i incidenteve të mos-përmbajtjes ndaj rregulloreve për produktet	16
30	PR3	Tipi i produktit dhe informacionet e kërkuara për shërbimin nga prodhuesi	16
31	PR4 *add	Numri i incidenteve të mos-përmbajtjes ndaj rregulloreve	16
1. Strategjia dhe analiza			
#	Shpjegimi		Faqe në raport
1.1.	Mesazh nga menaxheri i përgjithshëm		9
1.2.	Ndikimet kryesore		7
2. Profili organizativ			
#	Shpjegimi		Faqe në raport
2.1.	Emri i organizatës		2
2.2.	Brendet primare, produktet dhe/apo shërbimet		16
2.4.	Lokacioni i selisë qendrore të organizatës		2
2.6.	Natyra e pronësisë dhe forma ligjore		2
2.7.	Tregjet e shërbyera		6
2.9.	Ndryshimet madhore gjatë periudhës së raportimit		16, 22, 37
2.10.	Shpërblimet e marra në periudhën e raportimit		10
3. Parametrat e raportimit			
#	Shpjegimi		Faqe në raport
3.1.	Periudha e raportimit		3
3.3.	Cikli i raportimit		9
3.4.	Kontakti për pyetjet në lidhje me raportin apo përmbajtjen e tij		4
3.5.	Procesi për definimin e përmbajtjes së raportit		3
3.6.	Kufiri i raportit		3
3.9.	Teknikat e ofrimit të të dhënave		3
3.13.	Verifikimi i raportit		3
4. Udhëheqja, zotimet dhe angazhimi			
#	Shpjegimi		Faqe në raport
4.8.	Politika dhe parimet e CSR		10 - 14
4.9.	Pjesëmarrja e menaxhmentit në çështjet e qëndrueshmërisë		12
4.10.	Performanca e menaxherit në lidhje me përgjegjësinë shoqërore të korporatës		12
4.12.	Kartat ekonomike, mjedisore dhe sociale, parimet apo		10, 11, 14, 19
4.13.	Anëtarësia në organizata		13, 17
4.14.	Lista e grupeve hisedarë		13, 14
4.16.	Përfshirja e hisedarëve		



SHARRCEM

a  **TITAN** Group Company